

THE KOSOVO BANKER

Bankimi në kohë të COVID-19



For a
**debt-free
world.**



There'll always be debt. Whether privately or in business, taking out a loan is part of life. However, if loans cannot be serviced, we use our self-learning collection software to find individual solutions for defaulting payers. By doing so, we demonstrate fair and realistic ways for achieving a debt-free life.

EOS. FOR A DEBT-FREE WORLD.





SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS
KOSOVO BANKING ASSOCIATION



THE KOSOVO BANKER

IMPRESSUM

BORDI I DREJTORËVE TË SHOQATËS SË BANKAVE TË KOSOVËS



Z. ALBERT LUMEZI
NLB Bank / Kryetar i Bordit të SHBK



Z. ROBERT WRIGHT
Raiffeisen Bank / Zv. Kryetar i Bordit të SHBK



Z. PETRIT BALIJA
Shoqata e Bankave të Kosovës



Z. ARTON CELINA
Banka për Biznes



ZNJ. ERIOLA BIBOLLI
ProCredit Bank Kosova



Z. MERITON SUNDURI
Ziraat Bank



Z. OGUZHAN CEYLAN
IS Bank



Z. ORCUN OZDEMIR
TEB Bank



Z. SELMAN LAMAJ
Credins Bank



Z. SUAT BAKKAL
Banka Kombëtare Tregtare



Z. SHPEND LUZHA
Banka Ekonomike

**KRYESHEF EKZEKUTIV I SHOQATËS SË BANKAVE
TË KOSOVËS DHE KRYEREDAKTOR:**
Z. Petrit Balija

REDAKTORE DHE ZYRTARE PËR KOMUNIKIM:
Znj. Anesa Besimi



SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS
KOSOVO BANKING ASSOCIATION

Shoqata e Bankave të Kosovës (SHBK) është zëri i industrisë bankare në Republikën e Kosovës. SHBK është përfaqësuese e bankave komerciale të Kosovës, anëtare të SHBK, në lidhje me çështjet sektoriale bankare dhe bashkëpunon me të gjitha autoritetet përfshirë Kuvendin e Republikës së Kosovës, Qeverinë, Bankën Qendrore, Institucionet Financiare Ndërkombëtare, Mediat me qëllim mbështetjen e stabilitetit dhe zhvillimit të sektorit bankar në Kosovë.

The Kosovo Banker është botim i Shoqatës së Bankave të Kosovës. Botohet dy herë në vit, me qëllim të informimit të saktë të publikut lidhur me industrinë bankare në Kosovë. Shoqata e Bankave të Kosovës; Rr. Lidhja e Pejës 177, Zona Industriale, Prishtinë; 10000. Republika e Kosovës; +381 38 246 171; www.bankassoc-kos.com; contact@bankassoc-kos.com;

PËRMBAJTJA

EDITORIAL

- 06 **Dr. Sc. PETRIT BALIJA** - Kryeshf Ekzekutiv -
Shoqata e Bankave të Kosovës

PARATHËNIE

- 07 **Qasja sistemike makroprudenciale e Kosovës në kërkim të stabilitetit financiar**
ALBERT LUMEZI

Kryetar i Bordit të Drejtorëve të SHBK-së
Kryetar i Bordit Udhëheqës të NLB-së

- 11 **BQK gjatë pandemisë COVID-19**

Dr. Sc. FEHMI MEHMETI

Gubernator i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

KËNDI I INTERVISTËS

- 14 **Intervistë me Z. ROBERT WRIGHT**

Zv. Kryetar i Bordit të Drejtorëve të SHBK-së & CEO, Raiffeisen Bank Kosova: Efekti i COVID-19 në sektorin bankar në Kosovë

- 15 **Intervistë me Znj. ERIOLA BIBOLLI**

CEO, ProCredit Bank Kosova: Bankat si pjesë e zgjidhjes në kohë pandemie

SEKTORI FINANCIAR

- 18 **Industria bankare në epokën e COVID-19 -**

Rreziqet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit - Dr.Sc. OZAN GÛLHAN - Udhëheqës i Divizionit të Pajtueshmërisë, TEB / **Dr.Sc. ALBAN HETEMI** - Menaxher i Departamentit të PPP dhe Kontrollit të Sanksioneve, TEB, Kryetar i Komitetit për PPP, SHBK

- 22 **Sfidat në procesin e "Njihe Klientin Tënd" në kohën e COVID-19 në sektorin bankar - DONIKA BAJRAMI DEVAJA** - Zyrtare në Departamentin e Pajtueshmërisë për PPP/FT Banka Ekonomike

- 24 **Sfidat e institucioneve financiare në kohën e pandemisë nga COVID-19 - ARDIAN KADRIAJ,** Drejtor i Shërbimit për Punë Juridike NLB Banka

- 26 **Mbrojtja e të dhënave personale sipas rregullores së përgjithshme për mbrojtjen e të dhënave (GDPR) dhe legjislacionit vendor për mbrojtjen e të dhënave personale - EDITA MUSLIU,** Zyrtare për mbrojtjen e të dhënave personale / Specialiste e GDPR, Raiffeisen Bank Kosova

- 30 **Bankat sfidohen por mbesin të qëndrueshme - TAULANT GUTAJ,**

Këshilltar ligjor për çështje gjyqësore- TEB Kosova

KËNDI I EKSPERTËVE

- 34 **Roli i skemave garantuese në luftimin e krizave ekonomike dhe financiare - BESNIK BERISHA,** Drejtor Menaxhues - Fondi Kosovar për Garanci Kreditore

- 38 **Ndikimi i COVID-19 dhe reagimi ndaj tij - Rasti i Kosovës - SYZANA DAUTAJ,** Koordinatore e Projektit për Zgjidhjen e Borxhit, IFC / Prof. Assoc. Dr. GENC ALIMEHMETI, Konsulent i IFC-së

- 42 **Zhvillimet në sektorin bankar gjatë pandemisë në Shqipëri - SPIRO BRUMBULLI** - Sekretar i Përgjithshëm i Shoqatës Shqiptare të Bankave

- 44 **Një pasojë që do të mbetet pas krizës së Corona është vëllimi i shtuar i kredive të këqija dhe borxhet e mbetura - KATERINA BOSEVSKA Ph.D.,** Drejtoreshë Menaxhuese në EOS Matrix për Maqedoni dhe Kosovë


AKTIVITETET E SHBK



- 57 **BANKAT FUQIZOJNË SHOQËRINË**



Depozitoni paratë tuaja në BKT dhe merrni interesin menjëherë



Norma efektive e interesit është e barabartë me normën vjetore të interesit



038 666 666 | www.bkt-ks.com

Depozita Avans

Ne jemi gjithmonë këtu!

EDITORIAL



DR. SC. PETRIT BALIJA
KRYESHEF EKZEKUTIV - SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS

Viti që po lëmë pas ka qenë një nga vitet më sfidues të gjeneratës tonë. Bota nuk është sfiduar në këtë mënyrë që nga njëqind vite më parë. Pandemia COVID-19 u shfaq pa ndonjë paralajmërim dhe ka shkakuar valë tronditëse në të gjithë globin dhe në të gjitha aspektet e jetës. Sektori bankar në Kosovë i është përgjigjur kësaj sfide dhe ndërmori të gjitha masat e nevojshme për të mbrojtur klientët e saj dhe për të ruajtur një sektor të qëndrueshëm bankar përgjatë fazave të ndryshme të mbylljeve ekonomike duke u bërë kështu një nga sektorët më të rëndësishëm që siguroi likuiditetin dhe fleksibilitetin e nevojshëm për ekonominë e vendit me qëllim që të tejkalohet kjo krizë.

Bankat kanë ndërmarrë veprime të matura ndaj nevojave të bizneseve dhe ekonomive familjare të ndikuar duke zbatuar një moratorium në shkallë të gjerë për shtyrjen e pagesave të kredive për periudha të caktuara kohore, duke hequr interesin ndëshkues dhe duke ruajtur historikun kreditor të klientëve. Në të njëjtën kohë, Banka Qendrore e Kosovës ka siguruar lehtësim rregullator që i mundësoi bankave hapësirën e nevojshme rregullatore për të reaguar ndaj kësaj situatë. Sektori bankar gjeti mënyra për të ofruar shërbime bankare në çdo kohë pa ndonjë ndërprerje, përfshirë edhe gjatë izolimeve ekonomike dhe masave të karrantinës për komuna të caktuara. Kjo është bërë në përputhje me të gjitha rekomandimet për mbrojtjen e shëndetit të punëtorëve dhe klientëve. Fatkeqësisht, sektori bankar kishte shumë punonjës të infektuar,

dhe disa nuk kanë qenë në gjendje ta kalojnë këtë infeksion dhe kanë humbur jetën e tyre ose të të dashurve të tyre. Ne si SHBK, shprehim ngushëllimet tona të sinqerta për të gjithë ata që humbën të dashurit e tyre gjatë këtij viti që shpresojmë të lëmë pas në një të kaluar të largët për të mos u përsëritur më kurrë.

Ne e dimë që pandemia nuk ka mbaruar akoma dhe ka ende masa të rrepta, por ne jemi me shpresë që vitin e ardhshëm 2021 do të shohim se më e keqja ka mbaruar me zbulimin e vaksinës anti-COVID që do të mbrojë njerëzit në të gjithë botën në mënyrë që ekonomia të mund të rikuperohet nga kjo situatë dhe njerëzit përsëri mund të kthehen në një jetë normale. Sektori bankar në Kosovë do të vazhdojë të ketë një rol kryesor në sigurimin e mbështetjes për ekonomitë familjare dhe bizneset ndërsa kalojmë këtë periudhë të vështirë në mënyrë që të dalim më të fortë në anën tjetër.

Ky botim i revistës 'The Kosovo Banker' i kushtohet temës 'Bankimi në kohë të COVID-19' dhe ne falënderojmë të gjithë autorët që kontribuan me artikujt e tyre.

Urojmë që viti 2021 të sjellë shëndet dhe të mira për të gjithë!

Sinqerisht,
Petrit Balija
CEO
SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS



**ALBERT LUMEZI**

Kryetar i Bordit të Drejtorëve të SHBK-së

Kryetar i Bordit Udhëheqës të NLB-së

Qasja sistemike makroprudenciale e Kosovës në kërkim të stabilitetit financiar

Kosova është një ekonomi e re me një normë konstante të rritjes ekonomike gjatë dekadës së fundit me një mesatare prej 3,5% në vit, ku nxitës kryesor të rritjes ekonomike janë investimet publike, eksportet e shërbimeve dhe konsumi. Një nga nxitësit kryesor të ekonomisë së Kosovës mbetet konsumi i cili gjithashtu varet shumë nga dërgesat nga diaspora e Kosovës. Fluksi vjetor i remitencave arrin vlerën prej më shumë se 850 milion Euro ose 12% të gjithsejt BPV-së. Nxitësit vendor të rritjes ekonomike varen shumë nga investimet publike të cilat gjatë dekadës së fundit kanë qenë projekte infrastrukturore. Duke pasur parasysh një strukturë të tillë ekonomike, financimi i investimeve publike për kontraktorët e projekteve infrastrukturore është mbështetur nga sistemi bankar. Përkundër rritjes së vazhdueshme ekonomike, tregu i punës i Kosovës nuk ishte në gjendje të absorbojë fuqinë punëtore në dispozicion në treg duke lënë shkallën e papunësisë mbi 25%. Ndërsa, deficit i llogarisë rrjedhëse është rreth 8% të BPV-së dhe një deficit fiskal i vazhdueshëm me rreth 2%. Një nga pengesat kryesore të ekonomisë së Kosovës mbetet struktura e saj dhe niveli mbizotërues i ekonomisë informale i cili vlerësohet të jetë 30%. Një nivel i tillë i informalitetit është një pengesë e vazhdueshme e zhvillimit ekonomik por edhe e konkurrencës lojale. Në rrethana të tilla duhet të merret në konsideratë një qasje më strukturore ndaj perspektivës së zhvillimit ekonomik.

QASJA MAKROPRUDENCIALE SI ORIENTIM SISTEMIK I RREGULLIMEVE TË MATURA RREGULLATORE DHE MBIKËQYRËSE

Vendosja e një qasjeje makroprudenciale ka për qëllim një paradigme më të gjerë të mbështetjes së stabilitetit financiar, duke shmangur ndikimet prociklike të masave të marra ndaj sektorit financiar, të cilat do të prodhonin efekte negative në fushat e tjera të ekonomisë, të cilat do të përfundonin në pasqyrimin e efekteve negative në sektorin bankar gjithashtu. Sa i përket qasjes makroprudenciale, Banka Qendrore e Kosovës ka avancuar drejt implementimit të një kornize të tillë të politikave.


Meqenëse tingëllon gjithashtu si proces i gjerë dhe kompleks me shumë perspektiva, qasja makroprudenciale kërkon gjithashtu një qasje më sistematike drejt adresimit të stabilitetit financiar.

Kështu, termi sistematik është shumë i rëndësishëm në këtë rast pasi që tregon harmonizimin e objektivave ndërinstitucionalë të politikëbërësve. Prandaj, kjo do të përkthehej në këto kohë, me qëllim të ruajtjes së stabilitetit të sistemit financiar, me implementimin e pakos për rimëkëmbje ekonomike në drejtim të qasjes në financa, me qëllim të reagimit sa me efikas dhe agjil. Kjo me të vërtetë do të kërkonte një qasje sistematike që do të thotë bashkëpunim efikas ndërinstitucional në drejtim të zhvillimit ekonomik dhe përputhshmërisë së qëllimeve. Kjo është e rëndësishme sepse rreziku sistematik shpesh ndërtohet ndër periudha të zgjatura



Fluksi vjetor i remitencave arrin vlerën prej më shumë se

850 MILION EURO



në mënyrë që të ndërmerren masat atëherë kur është e nevojshme për të shmangur kostot e tepërta të vendimmarrjes së vonuar, e cila fatkeqësisht tashmë po rritet në një ekonomi të brishtë të Kosovës.

Kështu që, qasja e BQK-së ndaj menaxhimit të krizës ka pasur dyfish efekte anësore pozitive, duke ndikuar drejtpërdrejt te huamarrësit dhe huadhënësit me moratoriumet, ndërsa gjithashtu me anë të rregullave të menaxhimit të rrezikut kreditor lejoi gjithashtu hapësirë për të shmangur ndikimin prociklik me një qasje më pak të rreptë të kreditimit për bankat. Një mjet i tillë makroprudencial lejon gjithashtu hapësirë për rimëkëmbjen më të shpejtë të ekonomisë përmes injektimit të kapitalit nga sistemi bankar dhe një mësimi të mirë të nxjerrë nga krizat financiare të vitit 2008.



Qasja e BQK-së ndaj menaxhimit të krizës ka pasur dyfish efekte anësore pozitive, duke ndikuar drejtpërdrejt te huamarrësit dhe huadhënësit.

Në aspektin e zhvillimeve pandemike dhe nivelit të rritjes së pasigurisë, e cila prodhoi një pengesë shtesë për sektorin bankar të Kosovës gjithashtu ka pasur një reagim të shkathët të bankave komerciale në tregun e Kosovës. Reagimi dhe adaptimi i shpejtë në aspektin operacional duke zgjeruar dhe përmirësuar shërbimet financiare ishte një sinjal shumë i rëndësishëm i maturimit dhe fleksibilitetit të sistemit bankar të Kosovës. Nën situata të papara më parë, bankat komerciale reagueshan me gatishmëri dhe me përgjegjësi në dy drejtime, drejtimi operacional i riorganizimit të operacioneve të bankave për të pasqyruar mjedisin e jashtëm të ndryshuar për të mbrojtur shëndetin dhe sigurinë e klientëve dhe stafit tonë, duke lejuar përsosmëri në ofrimin e shërbimeve që u pasua nga



lehtësime të masave ndaj huamarrësve në kuadër të opsioneve rregullatore të disponueshme.

Kështu, për të zbatuar një nga mjetet makroprudenciale të disponueshme për ruajtjen e stabilitetit financiar dhe qëndrueshmërisë së huamarrësve, bazuar në vendimin e BQK-

së, bankat kanë vënë në dispozicion masat e moratoriumit si një reflektim i tkurrjes ekonomike dhe ndikimet e saj në pozicionin financiar të klientëve tanë. Sigurimi i masave për moratorium ishte masa e parë dhe e menjëhershme e ofruar nga bankat për një periudhë tremujore. Si rrjedhojë,

ndërsa situata u zhvillua me pasiguri mbizotëruese në treg, si një masë e dytë e marrë nga bankat drejt zhvillimeve të tregut ishte futja e masave të ristrukturimit me zgjatjen e maturitetit të ekspozimeve ekzistuese për 12 muaj. Në këtë mënyrë, është bërë sigurimi i huamarrësve me mjete për të përballuar aktivitetet ekonomike të kontraktuara. Për të lehtësuar procesin e përballimit të aktiviteteve ekonomike të tkurrura, bankat komerciale iu kanë ofruar konsumatorëve shtyerje të pagesave të interesit dhe kryegjësë, duke siguruar kështu pagesa të zgjatura të kësteve tashmë të kontraktuara.

Duke marrë në konsideratë pasqyrimin e zhvillimeve makroekonomike në sistemin bankar, duhet theksuar se sistemi bankar si i tillë gjithashtu u ndikua në mënyrë të konsiderueshme nga efektet ekonomike të prodhuara nga pandemia. Sidoqoftë, qëndrueshmëria e kapitalit të sistemit bankar me indikatorin e adekuatshmërisë së kapitalit prej 17% të shoqëruar me një kualitet të shëndoshë të aseteve dhe likuiditetit i cili i mundëson sistemit bankar një qëndrueshmëri ndaj situatave të tilla të stresuara.

Si pjesë e reagimit të përgjegjshëm ndaj ndikimit të COVID-19 ndaj veprimtarive të bankave, janë hapur rrugë të

reja për sa i përket sjelljes së klientit në drejtim të përshtatjes me normalitetin e ri. Një model i tillë mundësoi shfaqjen e mundësive të reja të përsosmërisë së operacioneve në drejtim të shërbimeve dixhitale që sjellin fryte të reja përfitimesh për klientët e sistemit bankar, një hap përpara drejt dixhitalizimit.

Sidoqoftë, pozicioni i tillë i sistemit bankar në përgjithësi duhet të kuptohet si një proces afatgjatë me praktika bankare të kujdesshme dhe të përgjegjshme në treg e cila është përkrahur dhe mbikëqyruar nga Banka Qendrore e Kosovës. Si i tillë, ky pozicion financiar i sektorit bankar gjithashtu duhet të jetë një nga mekanizmat ose nxitësit e potencialit të zhvillimit ekonomik për Kosovën, duke pasur parasysh vetëm një qasje sistematike. Një qasje e tillë do të lejojë jo vetëm një strategji më gjithëpërfshirëse dhe më largpamëse, por gjithashtu ofron mundësi për të ndryshuar strukturën ekonomike të Kosovës, me qëllim të rritjes së produktivitetit të ekonomisë në segmentin e prodhimit dhe rritjes së eksporteve të mallrave gjithashtu, duke ndikuar kështu pozitivisht në deficitin tregtar të vendit dhe duke ndihmuar në tejkalimin e streseve aktuale të zinxhirit furnizues.

Shkarko
NLB PAY
FALAS



A e keni provuar
sa i lehtë është
përdorimi i **NLB PAY**?





DR. SC. FEZMI MEHMETI
 Guvernator i Bankës Qendrore
 të Republikës së Kosovës

BQK gjatë pandemisë COVID-19

Pandemia COVID-19 si në Kosovë ashtu edhe në mbarë botën ka afektuar negativisht të gjitha proceset shoqërore dhe në veçanti aktivitetet ekonomike. Pandemia COVID-19 ka shkaktuar pasoja përtej atyre shëndetësore. Përpjekjet për të parandaluar përhapjen e pandemisë kanë ndikuar negativisht në të gjitha aktivitetet ekonomike e sidomos në sektorin e shërbimeve. Kjo pandemi ka shkaktuar recesionin më të madh global që nga lufta e II-të botërore.

Sektori bankar para pandemisë ka qenë shumë stabil, gjë që ka ndihmuar në tejkalimin e vështirësive ekonomike gjatë fazës së parë të pandemisë. Në fund të shkurtit 2020, bankat kishin nivele të larta të mjaftueshmërisë së kapitalit dhe të likuiditetit. Ky stabilitet ishte rezultat i menaxhimit të mirë dhe mbikëqyrjes prudenente përgjatë viteve.

Në fillim të pandemisë është aktivizuar Ekipi i Vazhdimësisë së Punës. Ky ekip është takuar 2 herë në javë apo më shpesh varësisht nga nevoja për të siguruar në vazhdimësi funksionimin e të gjitha proceseve të punës. Gjatë gjithë kohës, është siguruar funksionimi i rregullt i sistemit të pagesave në mbarë vendin, përfshirë këtu edhe zonat të cilat kanë qenë të izoluara për një periudhë më të gjatë kohore.

Me qëllim të mbikëqyrjes më të përafërt të sistemit financiar, BQK-ja ka kërkuar raportim në baza ditore nga të gjitha bankat

lidhur me pozicionet kryesore financiare të tyre e në veçanti të mjeteve likuide dhe depozitave dhe ka qenë e gatshme për të siguruar likuiditet në rast se një gjë e tillë do të ishte e nevojshme.

Me qëllim të ballafaqimit sa më efektiv me situatën e krijuar, kemi koordinuar veprimet me të gjitha institucionet e Kosovës dhe mbesim të gatshëm për të ofruar çfarëdo ndihme apo këshille që do të na kërkohet. Ne kemi qenë në komunikim të rregullt me partnerët tanë ndërkombëtarë, siç janë FMN-ja, Banka Botërore, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), si dhe me odat ekonomike në Kosovë. Si rezultat i komunikimeve tona të vazhdueshme është aprovuar RFI (Rapid Financing Instrument) nga FMN-ja në shumë prej 52 milion euro për të mbuluar nevojat urgjente dhe të përkohshme të bilancit të pagesave si rezultat i pandemisë COVID-19.

Pas kontakteve me bankat qendrore të regjionit dhe se bashku nën ombrellën e Vienna Initiative dhe mbështetjes nga BERZH-i, Banka Qendrore Evropiane ka aprovuar kërkesën e BQK-së për të vendosur një linjë financimi 'Repo' në shumë prej 100 milion euro. Kjo linjë e financimit, e cila është e vlefshme deri më 30 qershor 2021, i mundëson BQK-së të huazoj likuiditet në valutën euro nga Eurosistemi, për të adresuar nevojat e mundshme të likuiditetit për

SI REZULTAT I
 KOMUNIKIMEVE TONA TË
 VAZHDUESHME ËSHTË
 APROVUAR RFI (RAPID
 FINANCING INSTRUMENT)
 NGA FMN-JA NË SHUMË
 PREJ

52
 MILION EURO

PËR TË MBULUAR
 NEVOJAT URGJENTE DHE
 TË PËRKOHSHME TË
 BILANCIT TË PAGESAVE SI
 REZULTAT I PANDEMISË
 COVID-19.

institucionet financiare në Kosovë në rast të mosfunksionimit të tregjeve për shkak të pandemisë COVID-19.

Duke pasur parasysh ndikimin negativ në aktivitetin ekonomik të vendit, BQK-ja së bashku me Shoqatën e Bankave kanë vendosur që të aplikohet moratorium për pagesat e kredive pa asnjë masë ndëshkuese për të gjithë klientët që janë afektuar negativisht nga pandemia, duke filluar nga data 16 mars 2020 deri më 30 prill 2020. Në ndërkohë kjo periudhë është zgjatur deri në 3 muaj. Ky moratorium ka siguruar likuiditet në ekonominë e Kosovës në një periudhë shumë të vështirë. Ky proces deri më tani ka shkuar mirë dhe BQK-ja është duke trajtuar dhe do të trajtojë të gjitha ankesat e klientëve. Pas përfundimit të

periudhës së moratoriumit, BQK-ja ka publikuar udhëzuesin për ristrukturimin e kredive me qëllim të vendosjes së kriterëve në të cilat duhet të bazohet procesi i ristrukturimit të kredive për huamarrësit në vështirësi financiare. Në situatën aktuale ristrukturimi i kredive është në interesin më të mirë të huamarrësve dhe institucioneve kredihënëse dhe do të ndihmojë në rimëkëmbjen ekonomike të Kosovës. Si rezultat i këtij vendimi është zvogëluar impakti i goditjes ekonomike dhe kjo tashmë është pranuar edhe nga Fondi Monetar Ndërkombëtar.

BQK-ja është pjesë e grupit punues për rimëkëmbjen ekonomike dhe ka dhënë kontribut të lartë si në hartimin dhe implementimin e masave që kanë

për qëllim rimëkëmbjen ekonomike. Sistemi financiar, e në veçanti bankat, do të kenë rol shumë të madh në rimëkëmbjen ekonomike të vendit. Sipas projeksioneve të fundit, BQK-ja parashikon rënie ekonomike prej -5.9% në vitin aktual, kryesisht për shkak të rënies së investimeve dhe eksportit të shërbimeve. Kjo rënie pritet të pasohet me një rritje ekonomike prej rreth 5% në vitin 2021. Në fund të muajit gusht 2020, depozitat ishin 4 miliardë euro me një rritje të lartë vjetore prej 10%. Likuiditeti i bankave mbetet gjithashtu i kënaqshëm, me një raport prej 37.3%. Në të njëjtën kohë, raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit ishte 16.5%, që do të thotë se sektori bankar i plotëson mjaftueshëm, madje i tejkalon, kërkesat rregullatore




BQK-ja së bashku me Shoqatën e Bankave kanë vendosur që të aplikohet moratorium për pagesat e kredive pa asnjë masë ndëshkuese për të gjithë klientët që janë afektuar negativisht nga pandemia, duke filluar nga data **16 mars 2020** deri më **30 prill 2020**.

Në ndërkohë kjo periudhë është zgjatur deri në **3 muaj**.

BQK-ja parashikon rënie ekonomike prej

-5.9%

në vitin aktual, kryesisht për shkak të rënies së investimeve dhe eksportit të shërbimeve.



Kjo rënie pritet të pasohet me një rritje ekonomike prej rreth **5%** në vitin 2021.

Në fund të muajit gusht 2020, depozitat ishin 4 miliardë euro me një rritje të lartë vjetore prej **10%**.

Likuiditeti i bankave mbetet gjithashtu i kënaqshëm, me një raport prej **37.3%**.

Në të njëjtën kohë, raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit ishte **16.5%**, që do të thotë se sektori bankar i plotëson mjaftueshëm, madje i tejkalon, kërkesat rregullatore për kapital.

për kapital. Duke pasur parasysh këtë nivel të mjaftueshmërisë së kapitalit dhe likuiditetit, bankat vlerësohet se janë në gjendje të vazhdojnë me kreditimin e ekonomisë, gjë që është shumë e nevojshme për rimëkëmbjen e saj dhe vazhdimin e rritjes ekonomike edhe në vitin 2021. Departamenti Amerikan i Shtetit ka publikuar raportin për klimën e investimeve për vitin 2020 për Kosovën, ku është dhënë vlerësim i lartë për sistemin financiar të vendit. Në këtë raport është theksuar edhe qëndrueshmëria e sektorit bankar, i cili mbetet mirë i kapitalizuar dhe fitimprurës si dhe me përmirësim të dukshëm në vitet e fundit. Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka mirëpritur përfundimet e

nxjerra në raportin e Komisionit Evropian (KE) për Kosovën për vitin 2019, i cili nje angazhimin dhe reformat e ndërmarra në sektorin financiar. Raporti thekson progresin që BQK-ja ka bërë në fushën e kërkesave të kapitalit dhe menaxhimit të riskut të bankave pas hyrjes në fuqi të rregulloreve mbi mjaftueshmërinë e kapitalit dhe raportin e leverazhit, të cilat janë në linjë me kornizën Basel III. Sipas KE-së, raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit konsiderohet si i qëndrueshëm dhe mjaft mbi minimumin e kërkuar rregullator prej 12%. Një hapësirë të veçantë raporti i KE-së i ka kushtuar zhvillimeve të lidhura me ndikimin e pandemisë në ekonominë e Kosovës, me ç'rast thekson masat e ndërmarra

nga ana e BQK-së për të ndihmuar huamarrësit në tejkalimin e vështirësive financiare që kanë buruar si pasojë e krizës. Me këtë rast, raporti përshkruan masat rregulatore dhe mbikëqyrëse të BQK-së, të cilat kanë mundësuar shtyrjen e pagesave të kësteve të kredisë për huamarrësit, si dhe kanë krijuar lehtësira për ristrukturimin e kredive.

BQK-ja vazhdon me kujdes të shtuar të monitorojë të gjitha zhvillimet ekonomike në vend dhe varësisht nga zhvillimi i ngjarjeve do të marrë masat e nevojshme për të mirëmbajtur stabilitetin financiar dhe për të minimizuar pasojat ekonomike nga pandemia me qëllim të mbështetjes së rimëkëmbjes së ekonomisë të vendit tonë.



Sipas KE-së,
raporti i
mjaftueshmërisë
së kapitalit
konsiderohet si
i qëndrueshëm
dhe mjaft mbi
minimumin
e kërkuar
rregullator prej

12%.

**ROBERT WRIGHT**

Zëvendës Kryetar i Bordit të Drejtorëve, Shoqata e Bankave të Kosovës
& CEO, Raiffeisen Bank Kosova

Intervistë: Efekti i COVID-19 në sektorin bankar në Kosovë

SI KANË KALUAR BANKAT GJATË PANDEMISË COVID-19?

Bankat kanë kaluar shumë mirë gjatë krizës COVID-19. Efekti i plotë financiar ende duhet të ndihet, por rezultatet e industrisë në fund të TM2 të vitit 2020 kanë qenë shumë të mira edhe në krahasim me vendet e tjera në rajon. Sidoqoftë, rezultatet financiare nuk janë përparësia e vetme për bankat dhe është shumë e rëndësishme që ne të vazhdojmë të veprojmë në mënyrë shoqërisht të përgjegjshme ndaj klientëve dhe stafit tonë në këto kohë të vështira. Në këtë kontekst, bankat u kanë dhënë mbështetje financiare një vargu të gjatë të nismave dhe ngjarjeve që lidhen me COVID-19 dhe gjithashtu kanë investuar në masa shumë efektive dhe shumë të rëndësishme për mbrojtjen dhe sigurinë e klientëve dhe stafit në të gjitha rrjetet e degëve.

Një zhvillim tjetër pozitiv gjatë pandemisë ka qenë migrimi i konsiderueshëm i klientëve në aktivitetet bankare jashtë degëve në kanalet bankare elektronike dhe në internet. Për shembull, numri i kartave pa kontakt është rritur për 29% nga viti në vit; ATM-të me mundësi të depozitimit të parave të gatshme janë rritur për 19%, ndërsa 78% e pagesave dhe transaksioneve tani bëhen në internet ose në celular.

A MENDONI SE BANKAT KANË QENË EFIKASE ME PROGRAMIN E SHTYRJES SË KREDIVE GJATË PANDEMISË?

Mendoj se po. Kjo ka qenë situatë unike dhe sfidë e paprecedent me të cilën industria bankare nuk ishte përballur kurrë më parë. Gjatë fundjavës së trembëdhjetë deri në të gjashtëmbëdhjetën të muajit mars ka pasur shkëmbim të madh të emailave midis bankave dhe një takim i rëndësishëm është mbajtur të dielën në mëngjes me Bankën Qendrore. Ka qenë shumë e rëndësishme që të gjitha bankat u janë përmbajtur dhe kanë qenë konsistente në zbatimin e afateve dhe kushtet të programit të moratoriumit dhe është rënë dakord që asnjë bankë të mos kërkojë të fitojë avantazh konkurrues nga kjo punë. Kjo ishte një nismë e përbashkët shoqërisht e përgjegjshme me klientin në fokus, ndërsa bankat ishin pjesë jetike dhe shumë e hershme

e zgjidhjes së problemeve makroekonomike të shkaktuara nga kriza e pandemisë.

Shumë kolegë nga të gjitha bankat dhe në funksione të ndryshme kanë punuar jashtë orarit për ta lansuar programin e shtyrjes së kredive brenda disa javëve pas marrëveshjes për kushtet e saj, ndërsa deri në fund të prillit janë shtyrë mbi 1.2 miliardë euro kredi duke u barazuar me x% e totalit të portofolit të kredive të kësaj industrie. Çfarë ka qenë po ashtu në të mirë të klientëve sa i përket skemës së moratoriumit të Kosovës ka qenë se të gjithë klientët janë përfshirë automatikisht në skemë, përveç nëse kanë vendosur që të dalin nga ajo në mënyrë aktive. Shumë vende të tjera në Evropën Qendrore dhe Lindore kanë operuar mbi bazën e “zgjedhjes”, ku kredimarrësve u është dashur ta arsyetojnë pezullimin e pagesave të kredisë.

SI E SHIHNI “NORMALEN E RE” PËR BANKAT NË NJË BOTË PAS COVID-19?

Bankat duhet ta kapitalizojnë mundësinë dhe apetitin për ndryshim që e ka krijuar pandemia. Ka pasur një lëvizje të rëndësishme të aktiviteteve bankare themelore në kanalet elektronike dhe ne duhet ta mbajmë këtë tempo dhe ta riprojektojmë rrjetin e degëve dhe funksionet e tij për t’u përqëndruar në përvojat më të thella dhe më tërheqëse të klientëve të nxitura nga aktivitetet relevante që krijojnë më shumë vlerë. Institucionet e tjera po ashtu duhet t’i pranojnë dhe t’u përgjigjen këtyre ndryshimeve si dhe të lehtësojnë krijimin e një ekonomie më dixhitale dhe të një ambienti më të automatizuar të jetesës.

Nga një këndvështrim më i gjerë, mendoj se industria bankare e Kosovës e ka përgjegjësinë që të bëjë gjithçka që është e mundur për t’i kontribuar rimëkëmbjes ekonomike të vendit, për të cilën do të duhen disa vite. Ne duhet të gjejmë ekuilibrin e duhur midis risk apetitit dhe përgjegjësisë sociale, ku bankat mund të jenë përgjigja ndaj problemit, e jo si në krizën e viteve 2009/10, shkaktare të problemit.



ERIOLA BIBOLLI
CEO, PROCREDIT BANK KOSOVA

Intervistë: Bankat si pjesë e zgjidhjes në kohë pandemie

CILAT JANË SFIDAT KRYESORE PËR SEKTORIN BANKAR NË KOSOVË GJATË PANDEMISË COVID-19?

Ne të gjithë kemi qenë spektatorë të kësaj krize shëndetësore globale të pa-precedentë që po shpaloset në ngjarje tejet me ndikim për botën dhe për Kosovën. Ndër të tjera, aktiviteti tregtar dhe ekonomik global pësoi një spirale rënësore të tkurrjes nën një kthesë të papritur të ngjarjeve, me ç' rast u trazuan zinxhirët e furnizimit global dhe u mbyllën shumë biznese. Përderisa Kosova po hyn në muajin e dhjetë të kësaj sfide, ne shohim se shtrirja e ndikimit tek familjet dhe ndërmarrjet e vogla e të mesme nuk dihet plotësisht, meqë të gjithë këta grupe po përballen me paqëndrueshmëri të rrjedhës së parasë që mund të kërcënojnë stabilitetin e tregut ekonomik dhe financiar. Mbështetja e synuar e politikave e orientuar kah sektori privat ka qenë jetike për ta siguruar funksionimin e ekonomisë. Çfarë është e dukshme është se në vorbullën e kësaj krize shëndetësore dhe ekonomike, bankat janë pjesë e zgjidhjes, duke qenë mekanizëm i rëndësishëm përballë kësaj tronditjeje ekonomike e sjellur nga pandemia COVID-19 dhe, si të tilla, ato janë përballur si me mundësi, ashtu edhe me sfida të paprecedent.

Meqënëse punonjësit dhe klientët tanë janë në qendër të vëmendjes sonë, sigurimi i shëndetit dhe sigurisë së tyre



Moratoriumi i madh i shtyrjes që u është ofruar të gjithë klientëve që kanë pasur nevojë dhe e kanë kërkuar këtë ka paraqitur sfida tejet të madhe nga këndvështrimi organizativ dhe teknologjik në periudhën afatshkurtër dhe sfida në matjen e riskut kreditor në planin afatmesëm.

gjatë kësaj krize ka qenë dhe vazhdon të jetë prioriteti ynë më i madh. Për këtë është kërkuar riorganizim i shpejtë, për ta mundur ndarjen dhe riorganizimin e ekipeve të brendshme, dhe për të siguruar kalimin e qetë tek puna në distancë. Në këto rrethana, sigurimi i vazhdimësisë së operacioneve, besueshmëria e platformave, furnizimi me para të gatshme dhe qasja e pandërrerë në shërbimet bankare, ka qenë sfida që ka shkaktuar një tendosje të madhe në operacionet e TI-së, logjistikës dhe ato të brendshme.

Për shkak të situatës së pandemisë dhe masave parandaluese që i kanë marrë autoritetet, ne e kemi parë një

rritje të pasigurive si rezultat i mbylljes totale apo tkurrjes së veprimtarisë në shumicën e bizneseve në vend. Të përballurit me këtë pasiguri dhe kohëzgjatja dhe shkalla e paqartë e pandemisë pa dyshim se ka ndikuar në marrjen e vendimeve. Përderisa fokusi ka mbetur në mbështetjen e klientëve të prekur, gjetja e një ekuilibri në plotësimin e kërkesës ekzistuese në një mënyrë të qëndrueshme dhe të shënjestruar është sfida me të cilën ne ende po përballemi.

Moratoriumi i madh i shtyrjes që u është ofruar të gjithë klientëve që kanë pasur nevojë dhe e kanë kërkuar këtë ka paraqitur sfida tejet të madhe nga këndvështrimi organizativ dhe teknologjik në periudhën afatshkurtër dhe sfida në matjen e riskut kreditor në planin afatmesëm. Sidoqoftë, përkundër të gjitha sfidave me të cilat është përballur, ky sektor ka vazhduar të japë hua dhe ta mbështesë në mënyrë të sigurt rrjedhën e kredive në sektorin privat.

Sa u përket depozitave, si burimi kryesor i financimit të veprimtarisë bankare, përkundër krizave globale që i prekur vendet nga të cilat vijnë remitencat tona, i tërë sektori ka reflektuar stabilitet dhe ngritje.

Siç është pritur, është parë një rritje e kredive të këqija. Për shkak të një perspektive ekonomike shumë të paqëndrueshme, humbjet e pritura të kredisë që ishin llogaritur më parë u desh të



rishikoheshin për ta marrë parasysh pasigurinë dhe shkallën e pandemisë.

Të gjitha këto ndodhi dhe masa kanë vënë presion mbi menaxhimin e të ardhurave dhe pritjeve të klientëve, përkundër marzheve të ngjeshura të të hyrave neto nga interesi.

E fundit, por jo më e parëndësishme, sfidë shumë e madhe për të gjitha bankat gjatë kësaj kohe ka qenë kufizimi i kontaktit njerëzor që ka kërkuar që çdo detyrë dhe shërbim të ofrohej përmes kanaleve online. Kjo vërtetë e ka vënë në test qëndrueshmërinë e sistemit financiar si nga këndvështrimi i punëdhënësit, ashtu edhe nga këndvështrimi i ofruesit të shërbimeve për klientët e tij. Kjo e ka sjellë përsëri diskutimin e modeleve të biznesit siç është bankimi direkt që ua mundëson klientëve që t'i kryejnë të gjitha transaksionet e tyre rutinore përmes kanaleve online.

Në rastin e ProCredit Bank, ne kemi kënaqësinë të themi se kjo ka qenë sfidë me të cilën jemi përballur pa asnjë pengesë për shkak të punës sonë të pa-

lodhshme dhe investimeve të vazhdueshme në dixhitalizimin e shërbimeve pas zhvillimit teknologjik global gjatë viteve të fundit.

Si përfundim, përkundër të gjitha rreziqeve të shtuara si rezultat i krizës ekonomike dhe sociale të shkaktuar nga pandemia COVID-19, në një mjeshtëri me marzhe të kompresuara, sektori bankar në Kosovë ka treguar qëndrueshmëri dhe vazhdon të jetë stabil, me cilësi të mirë të portofolit kreditor, pra me KJP-në më të ulët në rajon, me nivel të likuiditetit të kënaqshëm dhe mirë të kapitalizuar. Përveç sfidave, vlen të përmendet se, gjersa jemi përballur me këtë krizë të paparë, një vrojtim kryesor dhe pozitiv është se pandemitë e kanë iniciuar një përshpejtim të dixhitalizimit, një fleksibilitet në ekuilibrin midis punës dhe jetës dhe një zhvendosje të prioriteteve kah qëndrueshmëria dhe zhdërvjelltësia, që e ka theksuar rëndësinë e të qëndruarit pranë klientëve dhe të punuarit në një marrëdhënie simbiotike dhe varësi jetike me ta.

SI PO KONTRIBUON REVOLUCIONI DIXHITAL NË GJENDJEN AKTUALE TË MARRËDHËNIEVE ME KLIENTË?

Revolucioni dixhital i ka prekur të gjitha industritë në mbarë botën, dhe bankimi nuk përbën përjashtim. Gjatë dekadës së fundit kemi parë një ndryshim të jashtëzakonshëm në mënyrën se si klientët bankojnë duke i përqafuar avantazheve që i ofron teknologjia dhe, në këtë aspekt, ne po ashtu shohim një trend shumë pozitiv në sektorin bankar në Kosovë. Të gjitha bankat që kanë arritur t'i përvetësojnë trendet dhe mundësitë e reja të dhëna nga teknologjia kanë qenë shumë më të përgatitura për tu marrë me situatën e paparashikueshme që ka ardhur si pasojë e pandemisë. Distançimi social duke qenë normë e re, marrëdhëniet me klientë janë lidhur ngushtë me kanalet dixhitale tërësisht të zhvilluara të shpërndarjes dhe komunikimit, me të cilat klientët janë ndjerë të njohur dhe nuk kanë hezitur t'i përdornin.



“NGA RREZIKU TE MUNDËSIA”

Meqë jemi përballur me situatë të re, ne kemi dëshmuar një rritje të përsheptuar të transformimit dixhital si nga sektori bankar, ashtu edhe nga klientët e biznesit, të cilët i kanë zhvendosur strategjitë e tyre për të mbijetuar në një mjedis të ri dhe po ashtu kanë gjetur mundësi të reja në treg, në përpjekje për t'i ruajtur dhe përmirësuar marrëdhëniet me klientë.

Prandaj, situata me COVID-19, e ka potencialin për tu bërë katalizator i fuqishëm që bankat dhe bizneset të merren me nevojat e tyre për përtëritje. Marrëdhëniet me klientët janë esenciale për të gjithë ofruesit e shërbimeve dhe duhet të jenë në qendër të vëmendjes gjatë kësaj periudhe.

Siç mund të pritët, fokusi tani duhet të jetë në proceset të cilat sot nuk janë mjaft të shpejta. Mjedi i ri dhe nevojat që janë imponuar nga ai do të çojnë në investime të mëtejshme nga bankat në sistemet e tyre, duke e vënë në zbatim automatizimin dhe teknologjitë dixhi-

tale të reja për t'i trajtuar disa nga pikat e dobëta që janë zbuluar gjatë pandemisë, duke i ruajtur marrëdhëniet me klientët nga largësia me ta, që është njëra ndër to. Me një punë nga infrastruktura e gatshme në shtëpi, ky sektor do të jetë i gatshëm për eventualitete të tilla në të ardhmen. Prandaj, nëse vitin e kaluar dixhitalizimi ka qenë çelësi i rezistencës në industrinë bankare, këtë vit, sfidat e paprecedentë që i ka imponuar përhapja e COVID-19 e bëjnë dixhitalizimin jetik për mbijetesën.

CILA ËSHTË PERSPEKTIVA E KREDIVE PËR VITIN 2021 MARRË PARASYSH PASIGURITË QË NA PRESIN?

Përderisa mund të përfundojmë se sektori bankar në Kosovë u është shmangur suksesshëm presioneve të menjëhershme të krizës së COVID-19, edhe në të ardhmen priten shumë pasiguri për shkak të zhvillimit që po e shohim me përhapjen e virusit, meqë rreziku i “valëve të njëpasnjëshme” ende mbetet.

Nëse shohim përtej krizës së menjëhershme dhe efekteve të vazhdueshme të pandemisë COVID-19, të gjithë pajtohemi se një sektor bankar i fortë është thelbësor për një rimëkëmbje të fortë dhe të shpejtë. Është esenciale që bankat të vazhdojnë ta luajnë rolin e tyre duke u ndihmuar klientëve të tyre që ta rindërtojnë sigurinë financiare dhe produktivitetin e bizneseve të tyre.

Me mbështetjen që vjen me ligjin për rimëkëmbjen ekonomike besimi do të vazhdojë të rritet, duke ndikuar pozitivisht në këtë sektor, ndërsa, me lehtësimin e masave kufizuese ne parashikojmë që kërkesa për financim nga bizneset do të vazhdojë të rritet kryesisht për nevoja të kapitalit qarkullues.

Siç pritët, kreditë e këqija do të rriten gradualisht pas përfundimit të periudhave të moratoriumit, duke ndryshuar midis industrive, ndërsa do të varen shumë nga shtyrsat ekonomike vitin e



Përkundër të gjitha rreziqeve të shtuara si rezultat i krizës ekonomike dhe sociale të shkaktuar nga pandemia COVID-19, në një mjedis me marzhe të kompresuara, sektori bankar në Kosovë ka treguar qëndrueshmëri dhe vazhdon të jetë stabil, me cilësi të mirë të portofolit kreditor, pra me KJP-në më të ulët në rajon, me nivel të likuiditetit të kënaqshëm dhe mirë të kapitalizuar

ardhshëm. Sidoqoftë, ne presim që KJP-të të vazhdojnë të jenë të menaxhueshme dhe të absorbohen me lehtësi nga sektori bankar në vend.

Gjatë tërë vitit 2021, bankave do t'u duhet të vazhdojnë të punojnë shumë për ta ruajtur veprimtarinë e tyre dhe për t'i mbështetur klientët e tyre, gjithmonë duke bërë partneritet me qeverinë dhe rregullatorët për ta mbrojtur ekonominë.

Nëse shohim përpara, janë disa fusha të veçanta të fokusit që do ta riformojnë këtë sektor dhe do ta mbështesin një rimëkëmbje më të fuqishme. Ky sektor vëmendje të veçantë duhet t'i kushtojë shërbimit të klientëve përmes kanaleve online me shërbime dinamike dhe relevante, t'iu përshtatet mënyrave të reja të punës dhe të ndërtojë organizata më stabile dhe më të shkathëta.

**DR.SC. OZAN GÜLHAN**

Udhëheqës i Divizionit
të Pajtueshmërisë, TEB

**DR.SC. ALBAN HETEMI**

Menaxher i departamentit të PPP
dhe kontrollit të sanksioneve, TEB
Kryetar i komitetit për PPP, SHBK

Industria bankare në epokën e COVID-19: Rreziqet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit

Në qytetin Wuhan, Kinë, një pneumoni, nga një shkak i panjohur, u zbulua për herë të parë në dhjetor 2019. Virusi njihet si COVID-19 (CoronaVirus Disease 2019), i cili vazhdon të përhapet në të gjithë botën. Kjo krizë pandemike është një sfidë globale në perspektivën e vuajtjeve njerëzore si dhe të ndikimit negativ ekonomik. Sipas Fondit Monetar Ndërkombëtar (World Economic Outlook Report, Prill 2020), së pari tronditja dhe humbja në lidhje me virusin dhe masat e marra për të mbrojtur njerëzit është e madhe. Së dyti, nuk është e qartë për sa kohë tronditja do të zgjasë pasi efektet janë katastrofike për shumicën e ekonomive në botë. Së treti, në situatën aktuale ekziston një rol shumë i ndryshëm për politikën ekonomike, kur shfaqen kriza të tjera, krahasuar me këtë krizë pandemike, politikbërësit përdorin mjete dhe strategji të ndryshme për të inkurajuar rritjen ekonomike dhe aktivitetin, duke stimuluar kërkesën dhe ofertën agregate. Sidoqoftë, kjo krizë pandemike dhe pasojat e saj kanë nevojë për masa dhe kontrolle të zgjeruara. Për më tepër, ekziston një nevojë e menjëhershme për të stimuluar aktivitetet ekonomike, veçanërisht sektorët ekonomikë dhe bizneset më të ndikuara.

Pandemia COVID-19 ka çuar në sfida të pashembullta globale, e cila siguron një mjedis të favorshëm për rreziqet e sigurisë financiare. Institucionet në mbarë botën, si Task Forca për Veprime Financiare (FATF), Banka për Rregullim Ndërkombëtar (BIS), Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin (UNODC) janë përgjigjur me deklarata, duke ofruar udhëzime për institucionet financiare, për të menaxhuar rreziqet e pastrimit të parave (PP) dhe financimit të terrorizmit (FT). Në të gjitha

deklaratat e tilla theksohet se ekziston nevoja për një vigjilencë të veçantë për rreziqet e reja të identifikuara, bashkëpunim të ngushtë dhe shkëmbim të informacionit midis aktorëve kryesorë.

Në krizën pandemike COVID-19 janë identifikuar disa kërcënime dhe çënueshmëri, të cilat karakterizohen vetëm për këtë periudhë dhe përfaqësojnë evaluimin e rreziqeve të PP dhe FT.



Pandemia COVID-19
ka çuar në sfida të pashembullta globale, e cila siguron një mjedis të favorshëm për rreziqet e sigurisë financiare.

RREZIQET FINANCIARE NË EPOKËN E COVID-19

Gjatë COVID-19 janë shfaqur një numër i kërcënimeve dhe i cënueshmërive. Sipas Interpol-it ka një rritje të kërcënimeve kibernetike të lidhura me “malicious domains”, “malware” dhe “ransomware”. Për më tepër, sipas vlerësimit të FATF (FATF (2020b)) është një rritje e rreziqeve të PP dhe FT, që vijnë nga krimi i lidhur me COVID-19, i cili mund të përfshijë, por nuk kufizohet në:

- A) Keqpërdorimin e shërbimeve financiare online dhe aseteve virtuale për të lëvizur dhe fshehur fonde të paligjshme; dhe
- B) një potencial për korrupsion në lidhje me fondet qeveritare si dhe ndihmën financiare ndërkombëtare.

Autoritetet mbikëqyrëse duhet të publikojnë tipologji dhe të këshillojnë institucionet financiare të qëndrojnë vigjilente në lidhje me kërcënimet kibernetike dhe të vlerësojnë dhe testojnë në mënyrë aktive kapacitetin e infrastrukturës ekzistuese, si pjesë e aranzhimeve të tyre të vazhdimësisë së biznesit. Puna në shtëpi me qasje në distancë në institucionet financiare, veçanërisht në industrinë bankare, ka rritur sulmet nga kriminelët kibernetikë. Kriminelët mund të përfitojnë nga nevoja e shtuar e bankave për të identifikuar dhe pranuar klientët e tyre online. Në rrethana normale, sulmet kibernetike dhe skemat e pastrimit të parave i ekspozojnë bankat ndaj një numri rreziqesh operationale dhe atë të reputacionit. Në rrethana të tilla të epokës së COVID-19, ato rreziqe mund të evoluohen dhe zgjerohen më tej.

Sipas FATF, për shkak të krizës pandemike COVID-19, mund të shfaqen disa rreziqe:

- Kriminelët, që gjejnë mënyra për të anashkaluar masat e kujdesit të duhur për klientin;
- Rritje e keqpërdorimit të shërbimeve financiare online dhe aseteve virtuale për të lëvizur dhe fshehur fonde të paligjshme;
- Shfrytëzimi i masave stimuluese ekonomike dhe skemave të falimentimit si një mjet për personat fizikë dhe juridikë për të fshehur dhe pastruar të ardhurat e paligjshme;
- Përdorimi i shtuar i sektorit të parregulluar financiar, duke krijuar mundësi shtesë për kriminelët për të pastruar fonde të paligjshme;
- Keqpërdorimi dhe përvetësimi i ndihmës financiare kombëtare dhe ndërkombëtare dhe fondeve emergjente;
- Kriminelët dhe terroristët shfrytëzojnë COVID-19 dhe rënien ekonomike për të kaluar në linja të reja biznesi me para të gatshme dhe me likuiditet të lartë në vendet në zhvillim.

Kriminelët mund të përfshihen në mashtrime financiare, duke ofruar mundësi investimi mashtruese në mënyrë që të përfshihen në skema mashtrimi/phishing, si dhe krime kibernetike me qëllim të keq ose mashtrues, mbledhje fondesh për bamirësi të rreme dhe mashtrime të ndryshme mjekësore, që synojnë viktima të pafajshme, kriminelë që përpiqen të përfitojnë nga pandemia, duke shfrytëzuar njerëz në nevojë urgjente për kujdes.

Për më tepër, sipas vlerësimit të FATF (FATF (2020b)) është një rritje e rreziqeve të PP dhe FT, që vijnë nga krimi i lidhur me COVID-19, i cili mund të përfshijë, por nuk kufizohet në:

- A) keqpërdorimi i shërbimeve financiare online dhe aseteve virtuale për të lëvizur dhe fshehur fonde të paligjshme; dhe
- B) një potencial për korrupsion në lidhje me fondet qeveritare si dhe ndihmën financiare ndërkombëtare.

COVID-19

ndryshoi sjelljen
kriminale kështu që
kriminelët përshtatën
modus operandi të tyre
për të maskuar burimet
e tyre të paligjshme
dhe duke i bërë paratë e
pista të duken të pastra.

KONSEKUENCAT E COVID-19 NË PROGRAMIN KPP

Programi Kundër Pastrimit të Parave (Programi KPP) është një komponent thelbësor i regjimit të pajtueshmërisë së bankave. Qëllimi kryesor i këtij programi është të mbrojë bankat kundër pastrimit të parave dhe të sigurojë që ato të jenë në përputhje të plotë me ligjet dhe rregulloret përkatëse. Për këtë arsye, hartimi, strukturimi dhe zbatimi i këtij programi është prioritet kyë i bankave. Programi KPP është i bazuar në rreziqe dhe është krijuar për të zvogëluar pastrimin e parave dhe rreziqet e financimit të terrorizmit. Elementet kryesore të Programi KPP janë:

- Një sistem të politikave dhe procedurave të brendshme (Njih Klientin Tuaj – Procesi i pranimit dhe rishikimit të klientëve, Kujdesi i duhur ndaj klientit, Kujdesi i duhur i shtuar ndaj klientit, Raportimi, Monitorimi, Ruajtja e të dhënave etj.);
- Një Zyrtar dhe Zëvendës Zyrtar i Pajtueshmërisë i caktuar për mbikëqyrje të përditshme të Programit KPP;
- Një program i vazhdueshëm trajnimi për punonjësit; dhe
- Funksionet e pavarura të auditimit (auditimi i brendshëm dhe i jashtëm) për të testuar Programin KPP.

Kriza e pandemisë COVID-19 po ndikon në kapacitetet e sektorëve publikë dhe privatë për të zbatuar kërkesat e Programit KPP. Kjo për shkak të masave të marra për shkak të izolimit dhe distancimit shoqëror. Shumë zyrtarë të parrandalimit të pastrimit të parave (në disa banka 100%) tani punojnë në distancë, gjë që ndikon në mënyrën tradicionale të punës së profesionistëve të tillë. Disa pasoja të COVID-19 në Programet KPP mund të jenë si më poshtë:

- COVID-19 ndryshoi sjelljen kriminale kështu që kriminelët përshtatën “modus operandi” të tyre për të maskuar burimet e tyre të paligjshme, duke i bërë paratë e pista të duken të pastra;
- Numri i transaksioneve financiare online është rritur dhe paratë janë zhvendosur për të fshehur fonde të paligjshme;
- Rregullatorët shtyn inspektimet në terren;
- Raportet e Transaksioneve të Dyshimta (RTD) - Vendet që ende mbështeten në sistemet e raportimit të bazuara në letër mund të përballen me vonesa në raportim tek Njësitë e tyre lokale për Inteligjencë Financiare (NjIF);
- Institucionet financiare kanë iniciuar plane të vazhdimësisë së biznesit dhe për shkak të krizës pandemike disa banka mbyllën degët përkohësisht;
- Staf i NjIF-së ka qenë dhe është duke punuar në distancë dhe me kapacitete më të ulëta në zyrë.

Ne konsiderojmë që përgjigjet e politikave KPP/LFT duhet të përcaktohen për të zbatuar një përgjigje efektive ndaj rreziqeve të reja të identifikuara, të cilat përfshijnë, por pa u kufizuar në:

- Një koordinim ndërmjet rregullatorëve dhe subjekteve raportuese për të vlerësuar rreziqet dhe sistemet për shkak të COVID-19;
- Lëshimi i qarkoreve të reja për të mbuluar rreziqet e reja të identifikuara gjatë COVID-19;
- Përdorimi me efikasitet i një qasje të bazuar në rrezik për kujdesin e duhur dhe monitorimin e transaksioneve;
- Shtimi i masave për zvogëlimin e rreziqeve të PP dhe FT për opsionet e pagesave elektronike dhe dixhitale;
- Institucionet financiare duhet të vazhdojnë të vendosin dhe të mbajnë një sistem dhe kontroll efektiv në mënyrë që të sigurojnë që sistemi financiar të mos përdoret për pastrim parash ose qëllime të financimit të terrorizmit.

Bazuar në rreziqet e identifikuara dhe deklaratat e lëshuara nga institucione të ndryshme ndërkombëtare, si FATF, EBA, UNODC, BIS, Interpol, një numër rekomandimesh për rregullatorët dhe/ose institucionet financiare mund të jenë si më poshtë:

- të mbeten vigjilent ndaj pastrimit të parave dhe teknikave

të financimit të terrorizmit, që mund të shfaqen për shkak të rënies ekonomike për shkak të COVID-19;

- të kryejnë një vlerësim kombëtar të rrezikut mbi ndikimin e COVID-19 në rreziqet e PP/FT si dhe sistemet;
- të rishikojnë/përditësojnë vetë-vlerësimet e rrezikut të PP/FT në përputhje me rreziqet e reja të identifikuara për shkak të COVID-19;
- të avansohet bashkëpunimi midis rregullatorëve dhe subjekteve të raportimit (p.sh. bankat);
- të rrisin kujdesin e duhur të klientit për produktet dhe shërbimet bankare dixhitale;
- mbikëqyrësit e regjimeve KPP/LFT duhet të planifikojnë aktivitete mbikëqyrëse në një mënyrë fleksibile, efektive dhe pragmatike që përfshin, por nuk kufizohet në, inspektime jashtë vendit, inspektime virtuale (kur është e mundur) dhe shtyrjen e disa inspektimeve në terren në zonat me rrezik të ulët;
- NjIF të publikoj tipologjitë e reja të PP/FT të identifikuara gjatë COVID-19, të cilat ndihmojnë institucionet financiare të rishikojnë dhe rikrijnë skenarët dhe indikatorët e tyre;
- institucionet financiare inkurajohen të përdorin një kujdes të duhur të thjeshtësuar për të përsheptuar përdorimin e fondeve të qeverisë në përgjigje të COVID-19.



**DONIKA BAJRAMI DEVAJA**Zyrtare në Departamentin e Pajtueshmërisë për PPP/FT
Banka Ekonomike SH.A

Sfidat në procesin e “Njihe Klientin Tënd” në kohën e COVID-19 në sektorin bankar

Gjatë karrierës së vet profesionale, secili person, duke përfshirë edhe personat të cilët punojnë në sektorin bankar, janë sfiduar me raste të vështira, të veçanta apo edhe me raste unike. Padyshim, një nga këto raste unike mund të vlerësohet situata momentale e shkaktuar nga pandemia COVID – 19 që e ka kapluar tërë botën.

Gjatë muajit mars saktësisht kur dhe filluan rastet e para të prekura me COVID-19 në Kosovë, filluan të ndiheshin ndikimet, sfidat dhe vështirësitë në performimin e procesit NJKT (Njihe Klientin Tënd) sipas ligjit, rregulloreve dhe procedurave të brendshme të bankave. Në këtë kohë, me vendim të institucioneve të Kosovës, kompanitë publike dhe private ishin të detyruara të punojnë me staf minimal në zyre, ndërsa pjesa tjetër ishin të obliguar të punonin nga distanca, në mënyrë që të respektoheshin masat mbrojtëse sipas OBSH.

PERFORMIMI I PARIMIT “NJIHE KLIEN- TIN TËND” MË I RËNDËSISHËM SE KURRË MË PARË

Një ndër sfidat më të mëdha për bankat në këtë periudhë pandemie konsiderohet të jetë procesi “Njihe Klientin Tënd”, kjo, pasi që është e pamundur të realizohen 3 fazat e NJKT- së në mënyrën

që janë realizuar deri më tani: identifikimi i klientit (mbledhja/kontrollimi i dokumenteve origjinale), vlerësimi i rrezikut dhe verifikimi i të dhënave dhe dokumenteve.

Identifikimi i klientit në kohën e karantinimit dhe detyrimit të mbajtjes së maskës konsiderohet të jetë sfidë për dy arsye: arsyeja e parë është ajo që jo gjithëherë klienti mund të jetë prezent në bankë në mënyrë që ta identifikojmë në bazë të pamjes fizike dhe e dyta është obligimi i mbajtjes së maskës si pasojë e së cilës mund të mos identifikohet personi i duhur.

Krahas dy arsyeve të cekura më lartë sfidë jo më pak e rëndësishme është kjo që në mungesë të prezencës së klientit,



**Çdo monedhë ka dy anë,
bota e sheh COVID-19 si një
pandemi globale ndërsa për
oportunistët paraqitet si një
mundësi perfekte të të bërit
punë të jashtëligjshme”**

punëtorët e sektorit bankar në shumë raste janë të detyruar të komunikojnë përmes kanaleve alternative: telefonit apo postës elektronike të cilat përmbajnë rrezik më të madh të keqpërdorimeve apo mashtrimeve me informata të klientëve.

“Çdo monedhë ka dy anë, bota e sheh COVID-19 si një pandemi globale ndërsa për oportunistët paraqitet si një mundësi perfekte të të bërit punë të jashtëligjshme”.

Meqenëse është e pamundur të realizohet procesi Njihe Klientin Tënd sipas procedurave në këtë periudhë, sektori bankar ka para vetes një mundësi të re, të operojë me dokumente elektronike përkatësisht verifikime elektronike për të përmbushur kërkesat ligjore rreth NJKT, duke lejuar më shumë fleksibilitet në verifikim të identitetit të klientit dhe duke përdorur mënyra të tjera në këtë fushë. Poashtu është një mundësi e mirë për të investuar në dixhitalizim dhe modernizim të mëtejshëm të sistemeve dhe platformave që përdoren në fushën e Njihe Klientin Tënd. E njëjta gjë është kërkuar edhe nga Organizata ndërqeveritare Task Forca e Veprimit Financiar (FATF) e cila përmes udhëzimeve të publikuara se si të parandalojmë veprimet e jashtëligjshme gjatë COVID-19, inkurajon dhe bën presion



në vazhdimësi për zbatimin e standardeve ndërkombëtare në lidhje me përdorimin e platformave dixhitale për identifikim të klientëve dhe shpërndarjen e shërbimeve financiare dixhitale për t'iu përmbajtur kërkesave të distancimit social.

Sfidë e re në gjithë sektorin bankar konsiderohet të jetë edhe trajnimi në fushën e NJKT në kohën e COVID-19. Duke qenë obligative dhe e domosdoshme ndjekja e trajnimeve në këtë kohë, në sektorin bankar ka qenë e kufizuar, edhe pse disa prej bankave është dashur të implementojnë module elektronike apo online në mënyrë që stafi të jetë i njoftuar në çdo kohë me ndryshimet që janë duke ndodhur në kohën e COVID -19.

Sfidë tjetër që mund të konsiderohet si njëra nga sfidat më të rëndësishme gjatë kohës së pandemisë është gjendja emocionale e stafit, të cilët merren di-



Sfidë e re në gjithë sektorin bankar konsiderohet të jetë edhe trajnimi në fushën e NJKT në kohën e COVID-19.

rekt me procesin e NJKT dhe që janë në kontakt të drejtpërdrejtë me klientët gjatë identifikimit të tyre dhe verifikimit të tyre, duke pasur parasysh rrezikun e bartjes së virusit nga klientët tek stafi. Si pasojë e kësaj ajo që COVID-19 ka theksuar, është nevoja për shërbime të dixhitalizuara, meqenëse për shumë shërbime bankare klientët nuk janë në gjendje të paraqesin

dokumente personalisht ose fizikisht si pasojë e respektimit të distancës shoqërore. Edhe po të ekzistonte mundësia që dokumentet të dërgohen përmes postës, përsëri do të ekzistonte rreziku i bartjes së virusit. Njëkohësisht dërgimi i dokumenteve personale në adresën e shtëpisë së klientit apo në filialet e bankës është një shqetësim i madh i sigurisë së informacionit.

ÇKA MUND TË NDODHË NË PROCESIN E NJKT PAS COVID-19?

Askush nuk mund të parashikojë sfidat, mundësitë, dhe zhvillimet e paplanifikuara në sektorin financiar pas situatës pandemike të COVID-19, por një gjë është e sigurtë, bota nuk do të jetë më e njëjtë pas kësaj ngjarje dhe njëkohësisht procesi i NJKT mund shihet si një perspektivë e re e dixhitalizimit e cila mund të kursejë bizneseve kohën dhe paranë.

**ARDIAN KADRIAJ**DREJTOR i Shërbimit për Punë Juridike
NLB Bank

Sfidat e institucioneve financiare në kohën e pandemisë nga **COVID-19**




Bankat dhe institucionet tjera financiare, i kanë akomoduar nevojat e klientëve të tyre për një ristrukturim të kështeteve të kredisë, duke mos i ngarkuar ata me penalitete apo me përkeqësim të statusit të kredimarrësit, duke qenë se mospagimi i obligimeve kreditore ka ardhur si pasojë e kushteve të vështira të kësaj situatë, e cila ishte dhe është, jashtë kontrollit të faktorit njeri. Kredimarrësit, qofshin ata individë apo biznese, gjendja financiare e të cilëve ju

është përkeqësuar nga situata e shkaktuar nga COVID-19, kanë përfituar dy herë shtyrje/moratorium, 3 dhe 12 muaj (varësisht prej rrjedhës së parasë) ose ristrukturim të tyre, bazuar edhe në udhëzimet e Bankës Qendrore të Kosovës. Ky është një proces që e ka mundësuar vetëm shtyrjen/ristrukturimin e obligimeve kreditore të kredimarrësve, por jo faljen e tyre.

Kredimarrësve, aftësia paguese e të cilëve nuk është prekur apo dëmtuar

nga kjo situatë e pandemisë së shpallur, kanë vijuar normalisht shlyerjen e detyrimeve të tyre.

Kredimarrësit të cilët i kanë plotësuar kushtet që të përfitojnë nga kjo lehtësi e ofruar, e kanë kontaktuar Bankën online dhe pastaj Banka i ka vlerësuar të gjitha kërkesat veç e veç, me qëllim të aprovimit apo refuzimit të tyre. I gjithë ky proces ishte i unifikuar dhe i bazuar në udhëzimet e Bankës Qendrore të Kosovës.



Pavarësisht kostove të rritura të kësaj zgjidhjeje të sforcuar gjatë kësaj periudhe me plot sfida, tarifave ndëshkuese dhe statusi i klasifikimit të klientit kanë mbetur të ngrira gjatë periudhës së moratoriumit të aprovuar, duke ndikuar kështu negativisht në efikasitetin dhe rritjen e bankave, për faktin se asnjë pako financiare e veçantë nuk ishte ndarë për ta asistuar sektorin bankar gjatë kohës së pandemisë nga COVID-19, marrë parasysh këtu edhe suspendimin e punës së sistemit gjyqësor dhe përmbaruesve tek të cilat gjendet një numër i madh i lëndëve që përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të portfolios së pakthyer në bilancin e bankave.

Masat lehtësuese të prezantuara më lart, ishin vetëm hapat e para të



Pandemia e shpallur nga COVID-19, ka krijuar një rrugë me shumë të panjohura, mirëpo e ka gjetur tregun bankar mjaftueshëm të përgatitur për ti përballuar këto sfida.

kontrollit të emergjencës, mbajtjes së situatës nën kontroll dhe daljes nga karantinimi. Institucionet bankare ishin vet pjesë e efekteve negative dhe humbjeve nga COVID-19, mirëpo industria bankare është munduar që krahas vështirësive brenda institucioneve të veta, njëkohësisht ta ruajnë edhe raportin e shëndetit individual të shoqërisë me shëndetin e ekonomisë duke ju mundësuar që ato të ecin së bashku.

Pandemia e shpallur nga COVID-19, ka krijuar një rrugë me shumë të panjohura, mirëpo e ka gjetur tregun bankar mjaftueshëm të përgatitur për ti përballuar këto sfida. Industria bankare mbetet e angazhuar maksimalisht për të ofruar të gjithë mbështetjen e nevojshme në kapërcimin e kësaj situatë të vështirë.

**EDITA MUSLIU**

Zyrtare për mbrojtjen e të dhënave personale / Specialiste e GDPR
 Departamenti i Pajtueshmërisë Raiffeisen Bank Kosova

Mbrojtja e të dhënave personale sipas rregullores së përgjithshme për mbrojtjen e të dhënave (GDPR) dhe legjislacionit vendor për mbrojtjen e të dhënave personale

E drejta e privatësisë dhe mbrojtja e të dhënave personale është përcaktuar me Kushtetutën¹ dhe legjislacionin e Kosovës, ashtu siç është përcaktuar në Konventat dhe instrumentet e tjera juridike europiane dhe ndërkombëtare,² përfshirë praktikën juridike.³ Megjithatë, dokumenti i fundit më i rëndësishëm për mbrojtjen e të dhënave personale është Rregullorja e Përgjithshme e Bashkimit Evropian (BE) për Mbrojtjen e të Dhënave⁴ e njohur si ‘GDPR’, në fuqi nga viti 2018.

Qëllimi kryesor i Rregullores që e ka shfuqizuar Direktivën paraprake të mbrojtjes së të dhënave (95/46/EC), është përforcimi i mbrojtjes së të dhënave dhe të drejtës së privatësisë për qytetarët e BE-së. Si rezultat i kësaj Rregullore, janë bërë, ndryshimet të rëndësishme që kanë të bëjnë me përforcimin e mekanizmave të mbrojtjes së të dhënave personale për qytetarët, mbrojtjen e të dhënave personale të fëmijëve në mënyrë të veçantë, zgjerimin e definicionit të të dhënave

personale, njoftimin për shkeljet e të dhënave, vlerësimin e ndikimit të përpunimit, rritjen e dënimeve për shkeljet, caktimin e zyrtarit për mbrojtjen e të dhënave personale, kërkesën për llogaridhënie të shtuar për përpunuesit dhe kontrolluesit e të dhënave dhe zgjerimin territorial të zbatimit të Rregullores. Në vitin 2019, në përputhshmëri me Rregulloren e përgjithshme apo GDPR, është nxjerrë edhe Ligji i ri i Kosovës për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.⁵ Ky Ligj, qartësisht, i përcakton të drejtat, përgjegjësitë, parimet dhe masat ndëshkuese lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësisë së individit, përgjegjësitë e institucionit përgjegjës për mbikëqyrjen e legjitimitetit të përpunimit të të dhënave dhe qasjen në dokumente publike.⁶ Përpunimi i të dhënave, është kërkesë në rritje, për shërbimet në të gjithë sektorët e shoqërisë, që duhet bërë në përputhshmëri të plotë me të drejtat dhe liritë themelore. Përfundimisht, kur e kërkon interesi publik

lejohen ‘kufizime’ të domosdoshme. Për shembull, siç është gjendja tani, me qëllim të parandalimit dhe mbrojtjes së shëndetit nga COVID-19, autoritetet shëndetësore mund të përpunojnë të dhëna të caktuara që kanë të bëjnë me gjendjet shëndetësore, seriozitetin dhe rrezikun e mundshëm. Për këtë, Agjencia për Informim dhe Privatësi, në vazhdimësi ka kërkuar që, çështja e mbrojtjes së të dhënave dhe privatësisë së qytetarëve, siç është, publikimi i të dhënave të personave të infektuar me COVID-19, nga institucionet publike e veçanërisht, nga institucionet shëndetësore, si kontrollues të të dhënave personale të pacientëve, të bëhet në përputhje të plotë me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-082, për mbrojtjen e të dhënave personale. Ndërsa, çështje tjera të ndërlidhura me mbrojtjen dhe sigurinë e të dhënave, të ndikuara nga pandemia, janë përshtatur nga organizatat apo bizneset sipas rrethanave, bazuar në politikat dhe mekanizmat e tyre të sigurisë.

1 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008, neni 36

2 Konventa Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, 1950 dhe Pakti Nderkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, 1966

3 Praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut, lidhur me të dhënat personale, 2018

4 Rregullorja e Parlamentit Evropian dhe Këshillit (BE) 2016/679 e 27 Prill 2016 për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe levizjen e lirë të të dhënave të tilla, dhe shfuqizimi i Direktivës 95/46 / EC

5 Ligji Nr. 06/L-082, 2019

6 Po aty, neni 1, para 1-2

7 Për më shumë, <https://aip.rks-gov.net/lajmi-single/482>



TË DHËNAT PERSONALE

E dhënë personale, konsiderohet 'çdo informacion në lidhje me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm ("subjekt i të dhënave"), me ç'rast person fizik i identifikueshëm është ai person, i cili 'mund të identifikohet drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt, veçanërisht duke iu referuar një identifikuesi në bazë të një emri, një numri identifikimi, të dhënave rreth vendndodhjes, një identifikues 'on-line', ose një apo më shumë faktorë specifikë për identitetin fizik, psikologjik, gjenetik, mendor, ekonomik, kulturor ose social të atij personi fizik, përderisa me privatësi, nënkuptojmë 'respektimin e jetës private dhe familjare, paceshëmërinë e banesës dhe fshehtësinë e korrespondencës së telefonisë dhe e komunikimeve të tjera, në pajtim me ligjin e zbatueshëm.'⁸

TË DREJTAT E SUBJEKTEVE TË TË DHËNAVE

Subjektet e të dhënave kanë të drejta të caktuara në raport me të dhënat e tyre personale, dhe si në vijim:

E drejta për t'u informuar (neni 11) – subjektet e të dhënave duhet të marrin çdo informacion që ndërlidhet me

mbledhjen dhe shfrytëzimin e të dhënave të tyre personale nga Kontrolluesi, në mënyrë të qartë, të kuptueshme dhe lehtë të qasshme që me rastin e marrjes së tyre, ashtu siç janë përcaktuar në Ligjin për Mbrojtjen e të dhënave personale. Të gjitha këto informacione duhet të jenë me shkrim ose me mjete tjera, duke përfshirë sipas rastit, me mjete elektronike. Informacioni mund të ofrohet edhe me gojë, në rastet kur subjekti është i identifikueshëm.

E drejta për qasje në të dhëna (neni 14) - subjektet e të dhënave, përmes kërkesës, mund të kërkojnë kopjen e të dhënave personale, dhe midis tjera sh, të kenë qasje në të dhënat personale dhe informacionin që ka të bëjë me qëllimet e përpunimit; kategoritë e të dhënave personale përkatëse; marrësit ose kategoritë e marrësve; afatin e parashikuar; të drejtën për korrigjim dhe fshirje të të dhënave personale ose kufizimin e përpunimit të të dhënave personale në lidhje me subjektin e të dhënave, ose për të kundërshtuar një përpunim të tillë; dhe të drejtën për të paraqitur një kërkesë tek Agjencia.

E drejta për korrigjim (neni 15) - nëse të dhënat nuk janë të sakta apo të pakompletuara, subjektet e të drejtave kanë të

drejtë që përmes një deklarimi shtesë të kërkojnë që ato të korrigjohen, dhe pa vonesa të panevojshme.

E drejta për fshirje apo 'e drejta 'për t'u harruar' (neni 16) - subjektet e të dhënave kanë të drejtë që të kërkojnë fshirjen e të dhënave personale të tyre. Kontrolluesi, është i detyruar të fshijë të dhënat personale, pa vonesë të panevojshme.

E drejta për ta kufizuar përpunimin (neni 17) - subjektet e të dhënave kanë të drejtë që të kërkojnë kufizimin apo shkatërrimin e të dhënave personale, bazuar në kriteret e përcaktuara.

E drejta për t'i bartur të dhënat (neni 19) - subjektet e të dhënave mund t'i bartin të dhënat e tyre tek një kontrollues tjetër, në çfarëdo kohe dhe sigurtë, pa asnjë ndërprerje të përdorimit të tyre.

E drejta për të kundërshtuar (neni 20) - subjektet e të dhënave kanë të drejtë që në çdo kohë të kundërshtojnë se si përdoren të dhënat e tyre për shkak të një situate personale të veçantë, qëllime të marketingut, shitje, apo qëllime tjera që nuk lidhen me shërbimin, përveç në rast të veprimtimit të autoritetit ligjor apo zyrtar, kur përpunimi është i nevojshëm për përmbushjen e një detyre të interesit publik.

⁸ Ligji Nr.06/L-082, neni 3, para 1.1. dhe 1.23

NË RAST SE AGJENCIA KONSTATON SE KA SHKELJE TË TË DHËNAVE PERSONALE, VARËSISHT NGA SHKELJA MUND TË VENDOSË GJOBË, APO PËR SHKELJE TË RËNDA DHE NË MASË TË MADHE TË DISPOZITAVE LIGJORE,

AGJENCIA MUND TË VENDOSË GJOBA NGA

20,000 €

DERI NË

40,000 €

OSE NË RASTIN E NJË KOMPANIE APO NDËRMARRJE, MUND TË VENDOSË GJOBË

2% - 4%

TË QARKULLIMIT TË PËRGJITHSHËM VJETOR TË VITIT FINANCIAR PARAPRAK NË PËRPTHJE ME RREGULLOREN (EU) 2016/679 TË PARLAMENTIT EVROPIAN DHE TË KËSHILLIT TË DATËS 27 PRILL 2016, MBI MBROJTJEN E PERSONAVE FIZIKË, PËR SA I PËRKET PËRPUNIMIT TË TË DHËNAVE PERSONALE DHE QARKULLIMIT TË LIRË TË KËTYRE TË DHËNAVE.

SHKELJET E TË DHËNAVE PERSONALE

Bazuar ne nenin 3 (para.1.27) ‘shkelje e të dhënave personale’, konsiderohet ‘çdo shkelje e masave të sigurisë që sjell asgjësimin, humbjen, ndryshimin, deklarimin e paautorizuar, aksidental ose të paligjshëm, ose qasjen në të dhënat personale të transmetuara, të ruajtura ose të përpunuara ndryshe’. Në rast të ndonjë shkeljeje, Kontrolluesi e njofton Agjencinë, jo më vonë se shtatëdhjetë e dy (72) orë, pasi që të jetë informuar rreth saj, përveç kur shkelja e të dhënave personale nuk mund të rezultojë në një rrezik për të drejtat dhe liritë e personave fizikë. Kontrolluesi dokumenton çdo shkelje të të dhënave personale që përbëhet nga faktet në lidhje me shkeljen e të dhënave personale, efektet e saj dhe veprimi korrigjues i ndërmarrë.⁹ Në rast se Agjencia konstaton se ka shkelje të të dhënave personale, varësisht nga shkelja mund të vendosë gjoba nga njëzet mijë euro (20,000) € deri në dyzet mijë euro (40,000) €, ose në rastin e një kompanie apo ndërmarrje, mund të vendosë gjobë 2% deri 4% të qarkullimit të përgjithshëm vjetor të vitit financiar paraparak në përputhje me Rregulloren (EU) 2016/679 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 27 prill 2016, mbi mbrojtjen e personave fizikë, për sa i përket përpunimit të të dhënave personale dhe qarkullimit të lirë të këtyre të dhënave.¹¹

AGJENCIA PËR INFORMIM DHE PRIVATËSI

Bazuar në nenin 57, Agjencia është autoritet i pavarur, përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij Ligji dhe rregulloreve të tjera për mbrojtjen e të dhënave personale dhe qasjes në dokumente dhe informacione publike. Agjencia i përgjigjet Kuvendit të Kosovës dhe udhëheqet nga Komisioneri,¹² organ i pavarur, i emëruar nga Kuvendi i Kosovës, në kuadër të Agjencisë, i cili është përgjegjës për sigurimin e zbatimit të këtij ligji dhe të Ligjit për qasje në dokumente publike.¹³

⁹ Po aty, neni 33

¹⁰ Po aty, neni 92 - 95

¹¹ Po aty, neni 105

¹² Po aty, neni 7 dhe 58

¹³ Po aty, neni 3, para 1.27

ZYRTARI PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE

Pozita e zyrtarit për mbrojtjen e të dhënave është e pavarur, të cilën Kontrolluesi apo Përpunuesi e cakton për monitorimin e përputshmërisë me rregullat e mbrojtjes së të dhënave, për ta informuar dhe këshilluar entitetin dhe të punësuarit që merren me përpunimin dhe për të bashkëpunuar me autoritetin mbikëqyrës,¹⁴ që vepron si pikë kontakti për Agjencinë për çështjet lidhur me përpunimin, përfshirë konsultimin paraprak, për çfarëdo çështje.¹⁵ Prandaj, me të drejtë, Zyrtari për mbrojtjen e të dhënave personale konsiderohet si ndërmjetës midis autoritetit mbikëqyrës, organizatës/biznesit dhe subjekteve të të dhënave. Kontrolluesi dhe përpunuesi e sigurojnë përfshirjen e duhur dhe me kohë, të zyrtarit për mbrojtjen e të dhënave në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të dhënave personale; e mbështesin zyrtarin për mbrojtjen e të dhënave në përmbushjen e detyrave të referuara ligjore; parashikojnë masat e nevojshme për t'i kryer ato detyra; i ofrojnë qasjen në veprimet e përpunimit të të dhënave personale dhe për të mirëmbajtur ekspertizën e vet. Zyrtari për mbrojtjen e të dhënave raporton drejtpërdrejt në nivelin më të lartë menaxhues. Zyrtari për mbrojtjen e të dhënave mund të kontaktohet nga subjektet e të dhënave në lidhje me çështjet që i takojnë përpunimit të të dhënave të tyre personale dhe për ushtrimin e të drejtave të tyre sipas këtij ligji.¹⁶

KUFIZIMET

Ashtu siç është parashikuar në nenin 22 të Ligjit, të drejtat e subjekteve të të dhënave mund të kufizohen në përputhshmëri me të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, dhe si masë e nevojshme dhe proporcionale për të garantuar, midis tjerash, sigurinë kombëtare, mbrojtjen, sigurinë publike, parandalimin, hetimin dhe ndjekjen e veprave penale, inetersin e përgjithshëm publik (financiar apo ekonomik), fuqizimin e kërkesave civile, mbrojtjen e të drejtave të subjektit të të dhënave apo të lirive të të tjerëve, procedurat e pavarura gjyqësore, parandalimin, hetimin dhe zbulimin e shkeljeve të etikës.

E DREJTA E ANKESËS

Subjektet e të dhënave, sipas legjislacionit kanë të drejtë në mjete të ankesës, dhe sipas kësaj, çdo subjekt i të dhënave ka të drejtë të paraqesë ankesë tek Agjencia, nëse konsideron se përpunimi i të dhënave personale, është në kundërshtim me parimet dhe dispozitat ligjore.¹⁷

PËRFUNDIM

Rregullorja e përgjithshme për mbrojtjen e të dhënave apo 'GDPR' ka përcaktuar një kornizë të përparuar dhe shumë të rëndësishme ligjore për mbrojtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, bazuar në të cilën është ndërtuar, edhe Ligji i Kosovës për mbrojtjen e të dhënave personale. Megjithatë, për arsye të njohura dhe jo të njohura, interpretimi dhe zbatimi i plotë i legjislacionit për mbrojtjen e

të dhënave personale, përgjithësisht ende mbetet çështje e hapur për përpunuesit dhe kontrolluesit e të dhënave personale, derisa, të dhënat personale vazhdojnë t'i ekspozohen rreziqeve të ndryshme. Nxjerrja e legjislacionit sekondar, do ta ndihmonte në zbatimin e kërkesave të identifikuar ligjore për plotësimin/përshtatjen e strukturave organizative lidhur me të dhënat personale, për zyrtarët e mbrojtjes së të dhënave personale, qartësimin e mëtejme të roleve dhe përgjegjësi të palëve të ndryshme që kanë të bëjnë me të dhënat personale, procedurat për komunikimin, njoftimin dhe raportimin e shkeljeve, të drejtat e subjekteve të të dhënave, si dhe çështje tjera të ndërlidhura. Nxjerrja e legjislacionit sekondar mbetet çështje edhe për Agjencinë si autoriteti mbikëqyrës i zbatimit të Ligjit, kur kësaj i shtohet edhe dështimi i dytë, në zgjedhjen e Komisionerit nga Kuvendi i Kosovës. Moszgjedhja e Komisionerit ka ndikuar në (mos) ngritjen e buxhetit dhe (mos)rekrutimin e stafit të Agjencisë.¹⁸ Harmonizimi i mëtejme për zbatimin sa më të mirë të legjislacionit, dhe realizimi i kërkesave të paraqitura më lartë në rastet ku këto ende nuk janë përshtatur apo plotësuar, e vendosë në një nivel tjetër mbrojtjen dhe sigurinë e të dhënave, dhe e ngritë besueshmërinë dhe kënaqshmërinë e subjekteve të të dhënave për shërbimet e ofruara.

¹⁴ Doracaku për Mbrojtjen e të dhënave personale, Agjencia Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut dhe Këshilli i Europës, 2018, fq. 37

¹⁵ Po aty, neni 39

¹⁶ Po aty, neni 38

¹⁷ Po aty, neni 52

¹⁸ Intervista me Zt. Jeton Arifi, Drejtor në Agjencinë për Informacion dhe Privatësi, 25 korrik 2020, <https://lajmi.net/>

**TAULANT GUTAJ**

Këshilltar ligjor për çështje gjyqësore
TEB SH.A, KOSOVA

Bankat sfidohen por mbesin të qëndrueshme


Njëri ndër digasteret e qëndrueshme të sistemit ekonomik padyshim është edhe sektori bankar i cili edhe në Kosovë si dhe në vendet tjera të botës është ndeshur dhe sfiduar nga pandemia COVID -19.

Izolimi dhe paralizimi i jetës publike kishte sfiduar dhe tregjet botërore ekonomike nga emergjencat që paraqiti COVID-19 të cilat mbeten dhe ishin edhe sfida kryesore e legjislacioneve juridike dhe praktikave ndërkomëtare edhe të shteteve më të zhvilluara të botës, pra duke përfshirë këtu padyshim edhe sistemin ekonomik - financiar e bankar edhe të Republikës së Kosovës.

Sektori bankar ndër problematikat e sistemit ekonomik dhe atij legjislativ gjatë periudhës së COVID-19 kishte vonesa enorme në kthimin e kredive në kohë dhe zhvillimit të biznesit të rregullt, gjë që përmbysi edhe planet zhvillimore të planifikuara për periudhën e parashikuar kohore të vitit 2020 apo dhe më shumë, ku kjo

gjendje mund të afektonte edhe në operimin e rregullt që mund të rrezikonte në njëfarë mënyrë edhe ekonominë nacionale duke ngërthyer në vehte edhe sektorin bankar. Gjithashtu, duke sfiduar edhe sistemin normativ dhe legjislativ në rregullimin e marrëdhënieve kontraktuale në gjendje të jashtëzakonshme mbi çështjet ekonomike në mënyrë të drejtë dhe ligjore.

Duke e ditur gjendjen dhe historikun e sektorit të qëndrueshëm bankar në Kosovë në raport me rajonin, politikat zhvillimore dhe strukturore që kanë tanimë një kohë të gjatë bankat në Kosovë, padyshim nën mbikëqyrjen e Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) dhe organizimin e mirëfilltë që sektori bankar ka edhe në kuadër të Shoqatës së Bankave të Kosovës (SHBK) ishte ndër pikat kyqe të qëndrueshmërisë së sektorit bankar që arriti t'i bëj ballë sfidave shoqërore. Në këtë rast, u përballuan edhe sfidat e COVID -19 me pasoja eventuale



**KOSOVA PRITEJ
TË KISHTE RITJE
EKONOMIKE PËR RRETH**

4%

**PARA PANDEMISË
COVID-19.**

**TANI NË PËRFUNDIM TË
VITIT 2020 PRITET TË
KETË RËNIE DERI NË**

-4.5%



ekonomike për shtetin në përgjithësi e me theks të veçantë edhe për sektorin bankar në Kosovë.

Organizimi i shpejtë dhe profesional i sektorit bankar në kuadër të Shoqatës së Bankave të Kosovës (SHBK) përmes departamenteve brenda SHBK-së, në përputhje edhe me rekomandimet dhe udhëzimet e dala nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK) dhe Qeveria e Kosovës bëri që ta ruajnë stabilitetin ekonomik përkatësisht atë të sektorit bankar.

Kur e gjithë kësaj i shtojmë edhe historikun paraprak të zhvillimit biznesor gjatë viteve 2018 – 2019 që kishte rritje në:

- A** kreditë bankare të korporatave për 9.8%,
- B** kreditë për ekonomi familjare u rriten për 10.4%, gjithmonë sipas statistikave dhe hulumtimeve nga Agjencioni i Statistikave të Kosovës 2019, ndërsa kur kësaj ia shtojmë edhe nivelin e ulët të kredive jo-performuese të cilat për vitin 2019 kishin rënë nga 2.7% në 2.1% , na jep të kuptojmë se sistemi bankar në Republikën e Kosovës gëzon një nivel të qëndrueshëm dhe stabil në raport me vendet e rajonit të cilat janë në një shkallë më të lartë të forcës ekonomike.

Sipas hulumtimeve Kosova pritej të kishte rritje ekonomike për rreth 4% para pandemisë COVID-19, tani në përfundim të vitit 2020 pritet të ketë rënie deri në 4.5%, gjithmonë duke i vlerësuar edhe anët pozitive se Kosova kishte borxh në nivel të ulët publik, si dhe depozita të larta, pra kjo ka mundësuar që edhe sektorin bankar ta ketë të qëndrueshëm dhe stabil në planifikimet biznesore të kësaj kategorie.

Përkundër të gjithave duke e ditur edhe faktin se sektori bankar varet edhe nga sektorët tjerë të ekonomisë që në kohën e pandemisë COVID-19 i ka vështirësuar edhe mirëqenien e qytetarëve me kufizime si masa mbrojtëse, kjo jep të kuptojmë dhe të urojmë në tejkalimin e shpejtë të kësaj gjendjeje të rënduar ekonomike e poashtu edhe të asaj sociale gjë që do t'i ndihmonte edhe sektorit bankar në rimëkëmbjen e saj zhvillimore në raport me planifikimet pozitive biznesore.

Pra nga vetë planet zhvillimore të sektorit bankar do të stimuloheshin ekonomitë familjare dhe ato të bizneseve të vogla, të mesme apo edhe të korporatave me lehtësirat e mundshme operationale dhe përmbajtësore në ofrimin e produkteve kreditore dhe produkteve tjera bankare me kushte të favorshme që do ta ndihmonin dhe do ishin një stimulim ekonomik për vendin dhe Republikën e Kosovës në përgjithësi.

Siguroni pronën tuaj
të financuar nga Banka

Siguroni automjetin tuaj
të financuar nga Banka



ILLYRIA
KOMPANIA E SIGURIMEVE

Çdo herë pranë 

www.illyriainsurance.com

 +381 38 750 850

 080075000



Siguroni shëndetin
e punëtorëve tuaj



ILLYRIA
KOMPANIA E SIGURIMEVE

Çdo herë pranë 

www.illyriainsurance.com

 +381 38 750 850

 080075000

**BESNIK BERISHA**

Drejtor Menaxhues
Fondi Kosovari për Garanci Kreditore

Roli i skemave garantuese në luftimin e krizave ekonomike dhe financiare

Tanimë, fakti që kriza shëndetësore e shkaktuar nga pandemia e COVID-19 do të ketë impakt negativ në ekonominë reale, është bërë realitet i dukshëm pothuajse në pjesën më të madhe të globit. Ekonomia e Kosovës nuk bën përjashtim nga situata e tillë dhe nuk do të mbetet immune ndaj ngadalësimit ekonomik të shkaktuar si rezultat i tronditjeve që kanë marrë oferta dhe kërkesa agregate nga kriza aktuale. Rënia e fuqisë dhe gatishmërisë blerëse, pezullimi i një pjese të investimeve private, si dhe ulja e aktivitetit kreditor nga bankat komerciale, janë disa nga pasojat e krizës ekonomike, që mëpastaj rezultojnë të jenë edhe shkaqe të thellimit dhe vështirësimit të situatës në të cilën gjendemi, në qarkun vicioz të ekonomisë së Kosovës.

Roli i ndërhyrjes së shtetit, nëpërmjet instrumenteve të politikës fiskale dhe monetare, për të ndihmuar ringjalljen e ekonomisë,

pas krizave ekonomike dhe financiare, është vendimtar. Përvoja nga krizat financiare dhe ekonomike në mbarë botën në të kaluarën si dhe në krizën aktuale,



Kreditimi konsiderohet një nga instrumentet kryesore për luftimin e mungesës së likuiditetit në treg, nxitjen e kërkesës agregate, investimeve private dhe si rrjedhojë mbështetjen e ringjalljes ekonomike, gjatë dhe pas krizave ekonomike.

na ka treguar që hendeku i krizës ekonomike, përveç nga shkak i krizës, varet shumë nga reagimi në kohë dhe gatishmëria e politikëbërësve për të luftuar pasojat e krizës dhe kthimin e besimit në ekonominë e vendit. Megjithatë, politika ekonomike intervencioniste, ndonëse e nevojshme për të luftuar pasojat e krizës, duhet të zbatohet me doemos me një strategji dalëse, në mënyrë që mos të krijojë varësi dhe joefikasitet në ekonomi, me ç'rast do të dekurajonte idetë dhe ndërmarrësitë e reja, si dhe do të promovonte praktika jo të mira që do ta dëmtonin meritokracinë, konkurrencën e lirë dhe veprimin e forcave të tregut të lirë në ekonomi.

Kreditimi konsiderohet një nga instrumentet kryesore për luftimin e mungesës së likuiditetit në treg,



nxitjen e kërkesës agregate, investimeve private dhe si rrjedhojë mbështetjen e ringjalljes ekonomike, gjatë dhe pas krizave ekonomike. Kjo është jetike për rimëkëmbjen e sektorit privat, të përfaqësuar nga NMVM-të, që burimin e vetëm të financimit e kanë në formë të kredive nga bankat komerciale. Sidoqoftë, gjykuar nga historia, bankat në periudhat pas krizave ekonomike dhe financiare, zakonisht janë më të kujdesshme në kreditim. Kjo sjellje deri diku racionale e bankave, duke mos pasur mundësi ta gjykojnë saktë aftësinë absorbuese të tregut për produktet dhe shërbimet për klientët e tyre dhe rrjedhimisht duke mos mundur të vlerësojnë performancën financiare të kredimarrësve potencial, ndërsa në të njëjtën kohë duke u munduar të jenë të përgjegjshme për të mbrojtur depozituesit (çdo përkeqësim i cilësisë së aseteve të sektorit

bankar është lajm jo i mirë për depozituesit), medoemos do të rezultojë në ngadalësimin e aktivitetit kreditor në ekonomi, apo duke e fokusuar kreditimin brenda një numri të përzgjedhur të klientëve, që nuk do të jetë i mjaftueshëm për të luajtur rol ndryshues në ekonomi, e që më vonë do të ndihmonte në revitalizimin e ekonomisë në tërësi.

Për të mundësuar kapërcimin e këtij ngadalësimi të aktivitetit kreditor, lind nevoja për të krijuar instrumente të caktuara, nëpërmjet të të cilave do të ndikohet në rritjen e ofertës dhe kërkesës për kredi. Skemat garantuese si instrumente që mundësojnë ndërmjetësimin financiar në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikojnë në rritjen dhe përmirësimin e ofertës për kredi, ndërsa në mënyrë indirekte ndikojnë edhe në rritjen e kërkesës për kredi.

POTHUAJSE, ASNJË INSTRUMENT TJETËR NUK MUND TË LUAJË ROL MË ADEKUAT SESA GARANCITË KREDITORE NË SITUATA TË TILLA, DHE ATË PËR SHKAK TË TRI ARSYEVE KRYESORE:

Siç u përmend më lart, karakteri i ndarjes së riskut, do të rrisë besimin midis bankave për rinisjen e huadhënies, meqë do të shërbejë si amortizues në rast të humbjeve nga kreditë e dështuara;

Ndikimi i garancive kreditore në ekonominë reale, për shkak të efektit shumëfishues të këtyre skemave, është shumë më i madh sesa me format e tjera të instrumenteve financiare;

Skemat e garancisë kreditore nuk promovojnë stimuj të gabuar në ekonomi, praktikë evidente për instrumentet tjera financiare të cilat duke marrë përsipër në tërësi detyrimet nga përfituesi i fundit (huamarrësi) për pagimin e kredisë dominohen nga sindromi “para falas” dhe së këndejmi krijojnë varësi dhe joefikasitet.

Me të drejtë, të gjitha paketat financiare të shteteve të ndryshme, apo institucioneve financiare ndërkombëtare, duke përfshirë edhe paketat e dizajnuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, në mekanizmat e tyre për të luftuar krizën aktuale të COVID-19, si nënkomponentë të rëndësishme, kanë paraparë krijimin e skemave të reja apo fuqizimin e atyre ekzistuese.

Fatbardhësisht, kriza e COVID-19 e gjen Kosovën me një institucion të themeluar dhe të konsoliduar mirë për ofrim të skemave garantuese. FKGK, është institucion i themeluar enkas për këtë qëllim, dhe vepron që nga viti 2016. Si i tillë, FKGK ka vazhduar të mbajë hapur linjat ga-



Për të mundësuar kapërcimin e këtij ngadalësimi të aktivitetit kreditor, lind nevoja për të krijuar instrumente të caktuara, nëpërmjet të cilave do të ndikohej në rritjen e ofertës dhe kërkesës për kredi.

rantuese gjatë gjithë kohës së krizës së fundit, përmes dy dritareve aktive – Dritarja e Rregullt dhe Dritarja për Bujqësi. Vetëm gjatë periudhës mars-shtator 2020, përmes këtyre dy dritareve janë garantuar kredi për 934 biznese, në vlerë prej EUR 34.4 mil. Përderisa vazhdojmë të mbajmë hapur këto dritare garantuese, institucioni është në pritje të miratimit të Ligjit për Rimëkëmbje Ekonomike dhe rritjen e bazës së kapitalit, me qëllim të mbështetjes së implementimit të Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike. Roli i FKGK-së në këtë pako është vendimtar, sepse parasheh zgjerimin e aftësisë garantuese, përmes përmirësimit të kushteve në drita-



ret ekzistuese, si dhe krijimit të katër dritareve të reja që do të mbulojnë nevojat specifike të katër segmenteve të caktuara të tregut, siç janë; ndërmarrësit e rinj, gratë në biznes, ndërmarrjet prodhuese, investimet në efikasitet të energjisë. Rritja e mbulueshmërisë së rrezikut nga 50% në 80% si dhe krijimi i mundësisë për të garantuar kreditimin e fermerëve, do të jetë vlerë e shtuar e FKGK-së në kuadër të Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Duke mbështetur investimet në këta sektor ne besojmë që FKGK, jo vetëm që do të ndihmojë sektorin privat të këndellet nga impakti i krizës, mirëpo edhe do të krijojë mundësi të reja për sektorë të caktuar strategjik, që rrisin aftësinë konkurruese të ekonomisë së vendit tonë, në krahasim me vendet e rajonit.

Bashkërendimi i aktiviteteve me Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe me donatorët ndërkombëtarë me qëllim të luftimit të impaktit negativ në ekonomi, ka qenë prioritet i FKGK-së gjatë tërë kësaj periudhe. FKGK-ja si institucion i themeluar me qëllim që të ndihmojë zhvillimin e ndërmarrësisë private, do të bashkëndiejë efektet e krizës me sektorin privat dhe atë bankar, shumë prej të cilëve tanimë janë klientë ose partnerë tanë. FKGK-ja, ndihmuar nga donatorët dhe partnerët, do të marrë përgjegjësi gjatë tërë fazave të rimëkëmbjes ekonomike. Është një betejë që strukturat qeverisëse të FKGK-së janë shprehur të gatshme ta ndërmarrin me vullnet, me të vetmin qëllim që ta kalojmë së bashku dhe të dalim edhe më të fortë nga kjo sfidë.

**SYZANA DAUTAJ**

Kordinatore e projektit për zgjidhjen e borxhit, IFC

**PROF. ASSOC. DR. GENC ALIMEHMETI**

Konsulent i IFC-së

Ndikimi i COVID-19 dhe reagimi ndaj tij - Rasti i Kosovës

S SI PO NDIKON COVID-19 NË AFTËSINË PAGUESE TË KOMPANIVE DHE INDIVIDËVE?

Pandemia COVID-19 ka ndikuar direkt në kompanitë duke ulur kërkesën për produktet dhe shërbimet e tyre, duke penguar zingjirin e furnizimit dhe shtrënguar dhënien e kredive. Ndonëse kjo gjendje është veçanërisht unike, historia ka treguar se një nga pasojat kryesore e krizave është rritja e pa-aftësisë paguese dhe si rrjedhojë, shtimi i rasteve të falimentimit. Ankthi fi-

nanciar tashmë është raportuar në sektorë të shumtë, veçanërisht në aviacion, turizëm, shitje me pakicë dhe prodhim. Tregjet dhe ekonomitë në zhvillim (EMDE) janë veçanërisht të prekshme për shkak të aftësisë së limituar financiare dhe ndjeshmërisë më të madhe ndaj vështirësive¹.

Çrregullimet në sektorin e kredive dhe në sektorët e prodhimit në përgjithësi, ndikojnë në mundësinë e sistemeve të pa-aftësisë paguese për të orientuar kompanitë e qënd-

rueshme në riorganizim dhe ato të paqëndrueshme drejt likuidimit. Regjimet e mirëfillta të falimentimit dizajnohen në atë mënyre që të shpëtojnë kompanitë e qëndrueshme dhe likuidojnë ato jo të qëndrueshme me kthim të aseteve të tyre në përdorim produktiv². Gjatë krizave sistemike, rreziku i likuidimit të kompanive të qëndrueshme rritet, veçanërisht atyre mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM), duke shkaktuar kështu humbje të panevojshme të vendeve të punës dhe



¹ Shënim i politikës së Bankës Botërore "Përhapja e COVID-19: Ndikimet në paaftësinë paguese të korporatave dhe individëve

² Shikoni Parimet e Bankës Botërore për Falimentimin Efektiv dhe Regjimet e Kreditorëve / Debitorëve (2016), <http://documents.worldbank.org/curat/en/518861467086038847/Principles-for-effective-insolvency-and-creditor-and-debitor-regimes>. Banka Botërore është caktuar nga Bordi i Stabilitetit Financiar (së bashku me UNCITRAL) si përcaktues bashkë-standard i Standardit të Falimentimit dhe të Drejtave të Kreditorëve: https://www.fsb.org/2011/01/cos_051201/.

shitje të shpejtë dhe me vlerë të ulët të aseteve. Nëse nuk adresohen këto efekte, rimëkëmbja ekonomike do të vazhdojë të çaloj edhe pas zbutjes së krizës. Andaj, është shumë e rëndësishme që kompanive të shëndosha t'u jepet rasti për të mbijetuar nga problemet e përkohshme të tregut.

ADRESIMI I SFIDAVE KRYESORE NGA POLITIKBËRËSIT

Qasjet e vendeve të ndryshme perëndimore ndaj kësaj situatë, deri më tani, kanë qenë një kombinim i vetëpërmbytjes rregulative, rritje e barrierave ndaj hyrjes në procedura zyrtare të falimentimit dhe zgjatje të afateve procedurale.

Disa vende kanë vendosur masa afatshkurtra për pa-afhtësinë paguese, që i ka siguruar bizneset dhe konsumatorët të kenë hapësirë për të marrë “frymë” derisa tregjet të stabilizohen dhe të bëhen vlerësime të qëndrueshmërisë së tyre. Këto masa afatshkurtra të miratuara si “reagime të shpejta”, përfshijnë krijimin e një moratoriumi të përkohshëm gjatë krizës së shkaktuar nga COVID-19, mbi procedurat e falimentimit dhe zbatimin kreditor. Këto masa, edhe pse të nevojshme për të parandaluar rritjen e rasteve të falimentimit, nuk paraqesin zgjidhje të qëndrueshme.

Ndër masave tjera, Organizata për Kooperim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) ka rekomanduar pezullimin e perkohshëm të detyrimit të kompanive që të aplikojnë për hapjen e procedurës së falimentimit, në rastin kur pa-afhtësia paguese shfaqet si pasojë e krizës pandemike. Kjo masë mund të zbatohet nga një moratorium i përkohshëm, që ka si synim parandalimin e ‘nxitimit drejt mbylljes’ nga ana e kompanive, apo të veprimeve të kreditorëve për të mbledhur borxhin. Në linjë me këtë qëndrim, Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar miratoi me shpejtësi Aktin e Falimentimit dhe Qeverisjes së Korpora-

NË NJË STUDIM TË BËRË NGA SHOQATAT E BIZNESIT NË KOSOVË, KUR U PYETËN NËSE COVID-19 KA NDIKUAR NË AFTËSINË E TYRE PËR TË MBIJETUAR

59.4%

E NDËRMARRJEVE KANË SHPREHUR SHQETËSIME NË LIDHJE ME AFTËSINË E TYRE PËR TË MBIJETUAR KRIZËS.

MEQË

99%

E BIZNESEVE TË KOSOVËS KLASIFIKOHEN SI NVM, MARRË PARASYSH PËRGJIGJET SIPAS MADHËSISË SË NDËRMARRJES, TREGOHET NJË KORRELACION I KUNDËRT MIDIS MADHËSISË DHE RREZIKUT TË MBIJETESËS, KU NDËRMARRJET MIKRO DHE TË VOGLA PERCEPTOJNË RREZIKUN MË TË LARTË PËR MBIJETESËN E TYRE

65%

DEKLARUAN SE MBIJETESA E TYRE ËSHTË E KËRCËNUAR

tave 2020 (aprovuar më 29 Shtator 2020), duke ofruar mbrojtje të përkohshme nga likuidimi i detyrueshëm.

Në perspektivë, ka nevojë për reforma të Falimentimit që do t'i përgjigjen fazës së rimëkëmbjes e që mund të konsiderohen si vazhdimësi apo si bashkëveprim me reforma tjera, varësisht nga rethanat përkatëse për secilin vend. Sistemi i falimentimit do të duhet të reagoj ndaj rritjes së dështimit të kompanive dhe ndaj rritjes së atyre që nuk mund të ristrukturojnë borxhet e tyre pa ndonjë ndihmë financiare jashtë gjykatës.

Në fund, përveç masave afatshkurtra të lartpërmendura, rekomandohet që të ndërmerren veprime afatgjata për të forcuar procedurat e ristrukturimit ndaj pa-afhtësisë paguese dhe për të përmirësuar efikasitetin e të gjitha procedurave të falimentimit në vend.

REGJIMI AKTUAL I FALIMENTIMIT NË KOSOVË

Efektiviteti i falimentimit komercial dhe regjimeve të rikuperimit të borxhit ndikon në klimën e investimeve dhe rritjen ekonomike. Kornizat efektive dhe rregullative ligjore zvogëlojnë rrezikun e kredisë, si dhe stimulojnë kreditorët të japin hua më shumë dhe me kamatë më të ulët. Një qasje sistematike ndaj falimentimit dhe rikuperimit të borxhit lehtëson daljen e biznesit pas vështirësive, sugjeron sigurimin e planeve të riorganizimit që krijojnë besim midis kreditorëve, debitorëve dhe punonjësve, ose zgjidh në mënyrë efektive mosmarrëveshjet tregtare midis debitorëve dhe kreditorëve.

Kosova përmes Ligjit për Falimentimin (miratuar në 2016) rregullon si aspektet thelbësore ashtu edhe ato procedurale të procedurave të falimentimit, duke përcaktuar likuidimin dhe riorganizimin dhe duke prezantuar procedura vijuese për debitorët dhe kreditorët. Ligji për Falimentimin është i zbatueshëm për bizneset — pronarë të vetëm, partneritete të përgjithshme, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe kompani me aksione — siç përcaktohet në Ligjin

SEKTORËT MË TË PREKUR NGA RËNIA DRASTIKE E PRODUKTIT JANË HOTELERI-TURIZMI DHE SHËRBIMET USHQIMORE, DISA SEKTORË PRODHIMI, TREGTIA ME SHUMICË DHE NJË PJSË E TREGTISË ME PAKICË DHE PASURITË E PALUAJTSHME DHE AKTIVITETET E BIZNESIT,

SIPAS BANKËS BOTËRORE, TKURRJA E VITIT 2020 PRITET TË ARRIJË NË

8.8%

KURSE RIMËKËMBJA DO TË JETË MË E GJATË.

për Organizimin e Bizneseve. Ligji për Falimentim nuk rregullon procedurat e falimentimit për institucionet financiare, kompanitë e sigurimeve, fondet e pensioneve, Ndërmarrjet me Pronësi Shoqërore dhe Ndërmarrjet Publike, të cilat rregullohen me ligje të tjera. Sidoqoftë, entitete të tilla mund të veprojnë si kreditorë në procedurat e përcaktuara me Ligjin e Falimentimit.

Një risi e ligjit të ri është është prezantimi i një kapitulli të vetëm për procedurat e shpejtuara të falimentimit për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM) (Kapitulli 2 i Ligjit për Falimentim). Inkurajimi i riorganizimit në një periudhë relativisht të shkurtër kohore është prezantuar për të adresuar vështirësitë e NVM-ve në lidhje me efektet e falimentimit, si një pengesë për veprimtarinë sipërmarrëse. ³Përgjatë procedurave të riorganizimit, gjykata cakton gjithashtu një monitorim në mesin e administratorëve të falimentimit për të shërbyer si këshilltar i debitorit në përgatitjen e një plani ekonomikisht të mundshëm të riorganizimit. Pas konfirmimit të një plani të riorganizimit,

një debitor i NVM gjithashtu merr një shkarkesë, përmes të cilit pretendimet që kanë ekzistuar më parë zëvendësohen sipas planit.

Ligji i ri gjithashtu forcon perspektivat e riorganizimit duke prezantuar debitorin në posedim si një parim tjetër për të demonstruar besim tek debitori dhe për të minimizuar stigmën e dështimit të biznesit gjatë procedurave të falimentimit. Në atë drejtim, roli i administratorëve të falimentimit në procedura është fleksibël, në varësi të rrethanave të një rasti të riorganizimit. Administratorët e falimentimit mund të veprojnë si përfaqësues të patundshmërisë kur debitorët në posedim hiqen nga gjykata, ose si mentorë kur debitorët shërbejnë si debitorë në posedim. Në procedurat e likuidimit, Administratorët e Falimentimit veprojnë si përfaqësues të patundshmërive.

PËRGJIGJJA NDAJ COVID-19 NË KOSOVË

Si në shumë vende të tjera, pas shfaqjes së pandemisë COVID-19, në Kosovë kishte kufizime në lëvizjen e njerëzve dhe

pjesë të konsiderueshme të ekonomisë u mbyllën për më shumë se dy muaj.

Në një studim të bërë nga shoqatat e biznesit në Kosovë, kur u pyetën nëse COVID-19 ka ndikuar në aftësinë e tyre për të mbijetuar, 59.4% e ndërmarrjeve kanë shprehur shqetësime në lidhje me aftësinë e tyre për t'i mbijetuar krizës. Meqë 99% e bizneseve të Kosovës klasifikohen si NVM, marrë parasysh përgjigjet sipas madhësisë së ndërmarrjes, tregohet një korrelacion i kundërt midis madhësisë dhe rrezikut të mbijetesës, ku ndërmarrjet mikro dhe të vogla perceptojnë rrezikun më të lartë për mbijetesën e tyre (65% deklaruan se mbijetesa e tyre është e kërcënuar)⁴.

Sektorët më të prekur nga rënia drastike e produktit janë hoteleri-turizmi dhe shërbimet ushqimore, disa sektorë prodhimi, tregtia me shumicë dhe një pjesë e tregtisë me pakicë dhe pasuritë e paluajtshme dhe aktivitetet e biznesit, Sipas Bankës Botërore, tkurrja e vitit 2020 pritet të arrijë në 8.8 për qind, kurse rimëkëmbja do të jetë më e gjatë. Rritja parashikohet të rikthehet në 3.7 për qind në vitin 2021, dhe më pas të përshpejtohet në 4.9 për qind në vitin 2022⁵.

Për të lehtësuar barrën financiare pas masave kufizuese u ndërmoren disa hapa, duke përfshirë:

- Institucionet e kreditimit ofruan mundësinë e shtyrjes së ripagimeve të kredive për tre muaj, si dhe mundësinë e aplikimit për ristrukturimin e kredisë
- Banka Qendrore e Kosovës.
- Qeveria e Kosovës miratoi pakon e parë "emergjente fiskale" me vlerë 190 milion Euro dhe propozoi devijimin e shpenzimeve të caktuara të buxhetit nga shpenzimet kapitale në paga, transferime dhe subvencione.

³ Komunikim nga Komisioni për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Evropian Ekonomik dhe Social dhe Komitetin e Rajoneve - Përmirësimi i Tregut të Vetëm: më shumë mundësi për njerëzit dhe biznesin (COM (2015) 550 finale).

⁴ Anketa mbi ndikimin e COVID-19 në ndërmarrjet e Kosovës - Prill 2020 (Pesë Shoqatat e Biznesit në Kosovë)

⁵ Ballkani Perendimor: Raport i rregullt ekonomik Nr.18 | Vjeshtë 2020- Banka Botërore

- Së fundmi, në dhjetor të vitit 2020 u miratua Ligji për rimëkëmbje ekonomike që parasheh mbështetje për kompanitë e vendit dhe qytetarët në vlerë prej rreth 560 milionë Eurosh - në fuqi deri në dhjetor të vitit 2021.

Si efekt i COVID-19 (d.m.th. krizë e pritshme pas tij), sistemet e pa-aftësisë paguese dhe zgjidhjes së borxheve do të bëhen edhe më të rëndësishme në vend. Aktualisht, sfida kryesore në Kosovë është të parandalohet situata ku kompanitë e qëndrueshme, veçanërisht NVM-të të shtyhen para kohe në falimentim.

Masat e ndërlydhura me pa-aftësinë paguese duhet të bashkërenditen me masat e miratuara fiskale dhe rregullative dhe, si të tilla, e rrisin gjasat e suksesit të tyre. Andaj, nevojitet mbështetje në funksionimin e duhur të mekanizmave për ristrukturimin e borxhit duke siguruar asistencë teknike për:

- të siguruar një moratorium nga vepurimet e kreditorëve për kompanitë që ka të ngjarë të bëhen të paafta të paguajnë. Moratoriumi do të lejojë kompanitë me paaftësi paguese ose kompanitë që ka të ngjarë të bëhen të tilla, për të marrë një numër të arsyeshëm ditësh në të cilat ata mund të kërkojnë të ristrukturojnë ose të kërkojnë investime pa veprime të kreditorit.
- mundësimin dhe inkurajimin e regjistrimeve elektronike, seancave gjyqësore virtuale dhe zgjidhjeve jashtë gjykatës në rastet e paaftësisë paguese;
- vendosjen në funksion të një kornize joformale jashtëgjyqësore për ristrukturimet e borgjeve, sa më shpejt që është e mundur, e që do ofronte ndihmë dhe qasje për një numër të madh kompanish të qëndrueshme por të goditura nga pasojat e pandemisë;
- përsheptimin e aktiviteteve që mundësojnë zbatimin e kornizave të paaftësisë paguese për sipërmarr-

ësit, të cilat nuk ekzistojnë apo nuk zbatohen si duhet në Kosovë;

- bërjen e studimeve dhe analizave diagnosticuese mbi 1) nevojën e futjes së kornizes së falimentimit për konsumatorë; 2) kornizen rregullative për pagesat në sektorin komercial (jo-financiar) që ndikojnë thelbësisht në likuiditetin e NVM-ve.



Nevojitet vendosja e një kornize joformale jashtëgjyqësore për ristrukturimet e borgjeve që ju ofrohet ndihmë dhe qasje një numri të madh kompanish të qëndrueshme por të goditura nga pasojat e pandemisë”

PROGRAMI I IFC-SË PËR ZGJIDHJEN E BORXHIT DHE DALJES SË BIZNESIT

Programi rajonal i IFC-së për Zgjidhjen e Borxhit dhe Daljes së Biznesit synon të përmirësojë sistemet e falimentimit në Ballkanin Perëndimor (Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë, Maqedoni të Veriut dhe Serbi) për një periudhë 4-vjeçare të zbatimit. IFC, anëtare e Grupit të Bankës Botërore, kryen këtë iniciativë në partneritet me qeverinë e Zvicrës, të përfaqësuar nga Sekretariati Shtetëror Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO). Ndikimi i pritshëm i zbatimit të Projektit është të zhvillojë një kornizë dhe praktikë fleksibile dhe efektive të falimentimit dhe para-falimentimit që do rezultojnë në ruajtjen e bizneseve të qëndrueshme sipas parimit të vijimësisë ose në

një likuidim efikas duke kthyer kështu asetet e bizneseve të padisponueshme në përdorim produktiv. Në aspektin afatgjatë, gjithashtu pritet të zvogëlojë rrezikun e huadhënies dhe si pasojë ta bëjë kredinë më të arritshme.

Në Kosovë në veçanti, qëllimi është që të nxisë mekanizmin e falimentimit në praktikë, por gjithashtu të promovojë zgjidhjen e rasteve jashtë gjykatës dhe procedurë të përsheptuar të ristrukturimit, si në të gjithë rajonin. Kjo do të arrihet përmes asistencës teknike të synuar për:

- përmirësimin e legjislacionit primar dhe sekondar për regjimin e falimentimit dhe para-falimentimit;
- forcimin e kornizës institucionale për administratorët e falimentimit;
- të rrisë kapacitetin e akterëve kryesorë në procesin e falimentimit; dhe
- të ndërtojë mekanizma për të promovuar përdorimin e sistemit të falimentimit.

RRETH IFC



IFC - një anëtar i Grupit të Bankës Botërore - është institucioni më i madh global i zhvillimit i përqendruar në sektorin privat në tregjet në zhvillim. Ne punojmë në më shumë se 100 vende, duke përdorur kapitalin, ekspertizën dhe ndikimin tonë për të krijuar tregje dhe mundësi në vendet në zhvillim. Në vitin fiskal 2020, kemi investuar 22 miliardë dollarë në kompani private dhe institucione financiare në vendet në zhvillim, duke shfrytëzuar fuqinë e sektorit privat për t'i dhënë fund varfërisë ekstreme dhe për të rritur prosperitetin e përbashkët. Për më shumë informacion, vizitoni www.ifc.org.

**SPIRO BRUMBULLI**

Sekretar i Përgjithshëm i Shoqatës Shqiptare të Bankave

Zhvillimet në sektorin bankar gjatë pandemisë në Shqipëri

Nëse kishte një situatë të padëshirueshme, të papritur, por jo fort të paparashikueshme, ajo ndodhi me fillimin e vitit 2020: Pandemia! COVID-19 hyri tashmë në histori jo vetëm si fakt, me viktima të shumta, por edhe me paralajmërim serioz për të ardhmen dhe rreziqet që e kërcënojnë jetën njerëzore.

Shqipëria, e ndodhur në një rajon ku predominon e ardhura nga turizmi, ka efektin e parë të prekjës njësoj si Kroacia, Mali i Zi, Greqia, Italia. Si një vend i vogël me një migracion të lartë, efekti i prekjës është i ngjashëm me atë të Kosovës. Si rajon, për shkak të mbylljes dhe kufizimeve të tjera, një stand by e investimeve të huaja të reja është gjithashtu një efekt tjetër negativ.

Por Shqipëria, përveç këtyre të përbashkëta me vendet e rajonit, ka edhe një disavantazh tjetër: efektet shkatërruese të tërmetit të 26 nëntorit 2019. Dy fatkeqësi të bëra bashkë në shumë pak muaj janë shumë për një vend me zhvillim si Shqipëria.

Parë në gjithë këtë panoramë, rënia ekonomike është e shpjegueshme dhe e pritur. Në tremujorin e dytë të këtij viti rënia e PPB ishte me -10.2%. Pritet që viti të jetë me një rënie në

intervalin nga -5 në -9 për qind dhe borxhi publik të rritet në 80%.

Industria bankare ka qenë ndër të paktët sektorë që nuk e ndërpreu

asnjëherë punën. Bankat e përqendruan vëmendjen e tyre te masat mbrojtëse të punonjësve, përshtatjes së logjistikës, marrjen e masave



për mbrojtjen e klientëve dhe shtimin e shërbimeve online. Duhet theksuar që industria bankare u gjet më se e përgatitur në këtë moment. Pasi përfundoi procesin e konsolidimit të vet gjatë viteve 2018 – 2019, ku 16 banka u reduktuan në 12, industria bankare mbetet e shëndetshme dhe e aftë të përballojë sfidën e pandemisë. Për më tepër që mësimet nga kriza e 2008 – 2010 ishin zbatuar drejt dhe riorganizimet, përshtatjet dhe zhvillimet drejt prirjeve e trendeve të reja ishin planifikuar vite më parë. Sektori bankar është përfshirë nga zhvillimet teknologjike ku 11 nga 12 banka sot ofrojnë e-banking. Pagesat online deri në 20 mijë lekë kryhen pa komision (me vendim të Bankës së Shqipërisë që nga 1 korrik 2020).

Industria bankare është nga sektorët më të organizuar në vend, sektori pararojë për nga organizimi, qeverisja korporative, standardet e punës, siguria dhe cilësia e shërbimit. Ajo karakterizohet nga rritja e prezencës së bankave lokale – katër banka janë me aksionarë vendas, kanë rreth 30 për qind të tregut. Pjesën më të madhe të tregut e zënë bankat me origjinë nga BE – 6 banka, 43 për qind të tregut. Është një përzierje e eksperiencave dhe standardeve më të mira evropiane me dinamizmin dhe vrullin lokal.

Bankat kanë vazhduar për më shumë se pesë vjet procesin e pastrimit të pasqyrave financiare, duke nxjerrë jashtë pasqyrës së gjendjes gati 500 milionë euro kredi të këqija. Ky proces ka rezultuar në uljen e kredive me probleme në 8.13%. Këto procese të thella janë shoqëruar me rritjen e kapitalit duke bërë që industria të jetë e mirë kapitalizuar, mbi 18 për qind nga 12 për qind që është kërkesa rregullative. Industria bankare është fitimprurëse, RoA është 1.28% dhe RoE është 12%.

Edhe viti 2020 nisi mjaft mirë. Tremujori i parë i këtij viti shënoi rritje me

bazë vjetore në kredi prej afro 7%. Për të njëjtën periudhë, depozitat u rritën me mbi 8 për qind. Këto prirje shumë pozitive dhe të mirëpritura u ndikuan nga periudha e mbylljes për shkak të COVID-19. Periudha prill – gusht më shumë u karakterizua nga shtyrja e kushteve të kredimarrësve që ishin prekur nga COVID-19 me një efekt prej rreth 120 milionë euro të lënë si likuiditet në duart e kredimarrësve dhe nga trajtimi i atyre klientëve biznes që plotësonin kushtet për të përfituar nga dy garancitë shtetërore për pagat e punonjësve dhe ringritjen e aktivitetit ekonomik. Periudha pas marsit karakterizohet nga rënia e ritmeve të rritjes së tremujorit të parë dhe rigjallërimi i aktivitetit financiar. Me bazë vjetore, në fund të gushtit, kredia u rrit me 4.1% dhe depozitat me 6.5%.

Aktualisht vendi është në një situatë ku ringritja ekonomike po shkon krahas për krahas me përballimin e valës së dytë të COVID-19. Kjo ringritje është shumë e rëndësishme për cilësinë e portofolit të kredive. Pas eksperiencës së keqe të krizës së 2008 – 2010 me kreditë e këqija, një rritje tjetër e kredive me probleme do të ishte gjëja e fundit që bankat mund të prisnin. Edhe pse realisht efekti në portofolin e kredive nga COVID-19 do të shihet në tremujorin e parë të vitit 2021, bankat kanë filluar të bëjnë llogaritjet e tyre shtesë në provigjione dhe për të mbajtur situatën nën kontroll. Bankat po mbajnë nën monitorim kredimarrësit e tyre duke analizuar vështirësitë dhe duke u ofruar mbështetje dhe ndihmë. Deri në fund të dhjetorit të këtij viti për rristrukturimet e kredive bankat nuk do të regjistrojnë provigjione shtesë dhe nuk do të ndryshojnë klasifikimin e kredimarrësit. Kjo është një lehtësi për të rregulluar situatën atje ku është e nevojshme për të mos penalizuar klientët. Edhe individët po ndiqen me



ME BAZË VJETORE, NË FUND TË GUSHTIT, KREDIA U RRIË ME

4.1%

DEPOZITAT ME

6.5%

kujdes të shtuar për shkak të riskut të humbjes së vendit të punës nëse masa kufizuese shtesë mund ndërmerren në javët në vazhdim në varësi të situatës pandemike.

Pra, dy rreziqet e evidentuara nga COVID-19 janë rënia e PPB dhe rritja e papunësisë. Rënia e PPB do të thotë se ka mungesë të parasë në treg, paraja diku mungon dhe kjo përkthehet në humbje. Humbja, nga ana e vet, ndikon në paaftësinë paguese të subjektit, për rrjedhojë në ripagimin e kredisë. Papunësia ka të bëjë me humbjen e të ardhurave të individëve që kanë kredi, që përkthehet në mungesë aftësie financiare për të ripaguar kredinë. Të dy këta faktorë kanë ndikim në cilësinë e portofolit të kredisë më shumë se në një situatë normale, sepse kanë ndikim të gjerë.

E rëndësishme është të shmangët një mbyllje e dytë. Me masat kufizuese të ndërmarra, edhe pse me vështirësi, humbjet do të jenë më të vogla dhe ringritja do të fitojë më shpejt në kohë.

**KATERINA BOSEVSKA PH.D.**

Drejtoreshë Menaxhuese në EOS Matrix për Maqedoni dhe Kosovë

Një pasojë që do të mbetet pas krizës së Corona është vëllimi i shtuar i kredive të këqija dhe borxhet e mbetura

Pas krizës financiare të vitit 2008 dhe krizës së borxheve të viteve 2010-2011, virusi Corona ia dha një goditje të re sektorit financiar dhe bankar, në një kohë kur institucionet në këtë sektor ende po përballeshin me çështjet e së kaluarës dhe problemet e atyre kohërave. Por, virusi Corona i ndaloi të gjitha. Subjektet afariste më të mëdha e më të vogla në të gjithë sektorët dhe degët e jetës shoqërore. E ndryshoi mënyrën e të jetuarit, mënyrën e të vepruarit dhe të qenurit në shoqërinë së cilës i përkasim.

Vlerësohet se sektori bankar tani është më i përgatitur për t'u marrë me tronditje të tilla të ngjashme me atë të vitit 2008. Konsiderohet se bankat tani kanë strukturë më të mirë të kapitalit dhe kanë shuma më të mëdha të parave të gatshme si rezerva krahasuar me situatën e vitit 2008 dhe e tërë kjo falë përshtatjes së vazhdueshme të bankave ndaj rregullave më të rrepta që janë përcaktuar gjatë periudhës së kaluar. Megjithatë, bankat evropiane kanë qenë nën presion të fuqishëm. Dhe, në një kohë kur sektori bankar po përpiqet në çdo mënyrë që të kthehet në pozicionin e tij në treg të para krizës së vitit 2008. Kur dukej sikur gati ia kishte dalë, lindi

kriza e coronës, e cila e përkeqësoi më tej situatën. Nëse e shikojmë indeksin bankar evropian do të vërejmë se ka rënë për më shumë se 50% në fillim të vitit 2020 krahasuar me marsin e vitit 2008. Shitjet e intensifikuara në tregjet globale të amplifikuara nga kriza e Co-

ronës kanë ndikuar që i njëjti indeks tani të jetë për 70% më i ulët krahasuar me marsin e vitit 2008.

Por çfarë ka mbetur pas krizave të viteve 2008 dhe 2010/11 (me të cilat sektori bankar ende duhet të merret) dhe si

NËSE E SHIKOJMË INDEKSIN
BANKAR EVROPIAN DO TË
VËREJMË SE KA RËNË PËR MË
SHUMË SE

50%

NË FILLIM TË VITIT 2020
KRAHASUAR ME MARSIN E VITIT
2008

SHITJET E INTENSIFIKUARA
NË TREGJET GLOBALE TË
AMPLIFIKUARA NGA KRIZA E
CORONËS KANË NDIKUAR QË I
NJËJTI INDEKS TANI TË JETË PËR

70%

MË I ULËT KRAHASUAR ME
MARSIN E VITIT 2008.

ndërlidhet apo çfarë ndikimi ka kriza e Coronës që po shfaqet tani në të?

NORMAT E ULËTA TË INTERESIT

Banka Qendrore Evropiane (BQE) i ka mbajtur normat e interesit në një rekord të ulët që nga kulmi i krizës së borxhit në vitin 2011. Diçka që mbetet akoma si rezultat i krizave të viteve 2008 dhe 2010/11 dhe për çka janë ankuar shumë burime të këtyre borxheve, sepse i ka minimizuar fitimet e tyre. Një qasje e tillë e ruajtjes së normave të ulëta të interesit në një nivel që konsiderohej normal i ka sjellë ekonomitë në një fazë të zhvillimit të ngadaltë dhe të vazhdueshëm, një fazë në të cilën kërkesa ka nevojë për stimulim të vazhdueshëm. Por, ndonëse tregjet presin që normat të mbeten të ulëta, kjo nuk mund të merret si e mirëqenë. Për shembull, ekziston mundësia që mbyllja e ekonomive dhe injektimi i

ndihmës dhe subvencioneve si reagim ndaj krizës së Coronës në një periudhë afatshkurtër në të ardhmen do të çojë në çmime më të larta, ndërsa presioni deflacionist në ekonomi ndodh kryesisht për shkak të çmimeve të ulëta të naftës, të cilat duket se nuk mund të bien nën nivelin e tanishëm.

KREDITË E KËQIJA

Kreditë e këqija janë njëri nga indikatorët kryesorë të gjendjes financiare të bankave dhe janë masa kryesore e riskut të kredisë në sistemin bankar. Përvoja tregon se rritja e kredive të këqija luan rol kryesor në procesin e krizave bankare. Çështja e kredive të këqija dhe efekti i tyre në ekonominë reale është shqetësimi kryesor i pothuajse të gjitha vendeve në botë dhe zgjidhja e kësaj çështje është parakusht për rikthimin e funksionalitetit të tregjeve financiare. Pasojë kryesore

e krizave të vitit 2008 dhe 2010/11 kanë qenë nivelet e larta të kredive të këqija nëpër banka, të cilat kanë përfshirë kreditë e këqija. Si rrjedhojë, janë marrë një varg masash për t'i ulur këto nivele të plasimeve të këqija në bilancet e gjendjes së bankave. Raportet e fundit nga Autoriteti Bankar Evropian (ABE) tregojnë se që nga qershori i vitit 2019, norma mesatare e kredive të këqija ka qëndruar në 3%, krahasuar me 6% në vitin 2015. Kreditë e këqija në Evropën Qendrore, Lindore dhe Juglindore arrijnë në 35.2 miliardë euro që nga 30 qershori i vitit 2019 për tërë rajonin, me një përqindje mesatare të kredive të këqija prej 4%, që është një përmirësim i dukshëm i gjendjes prej 9.8% në mars të vitit 2014. Vëllimi i kredive të këqija, në qershor të vitit 2019, ka rënë për 8.4% brenda një viti. Dhe kur dukej se për shkak se niveli i kredive të këqija ishte në rënie, vëmendja duhej të përqendrohej në përmirësimin e sistemeve të të dhënave nëpër banka dhe parandalimin e flukseve të reja të kredive të këqija si dhe identifikimin e problemeve të konsumatorëve në një fazë të hershme, shfaqja e krizës së Coronës solli sfida të reja. Kjo krizë pritet ta sjellë një problem në bilancet e gjendjes së bankave përsëri duke e rritur nivelin e kredive të këqija, veçanërisht pasi që kriza e Coronës ndikon drejtpërdrejt në jetën e disa bizneseve të vogla dhe të mesme që tani janë të detyruara të mbyllen apo nuk kanë mundësi t'i shlyejnë borxhet e tyre rregullisht. Prandaj, pritet që në shumicën e vendeve të eurozonës kreditë e këqija të arrijnë nivele edhe më të larta se ato të krizës së vitit 2008 (ndonëse ndërkohë është arritur që ato të zvogëlohen dukshëm me një varg masash që janë marrë).

Zakonisht, bankat hezitojnë t'i fshijnë kreditë e këqija nga bilancet e



gjendjes së tyre për shkak të implikimeve të kësaj procedure në profite dhe në saldo. Ato preferojnë ta mbajnë vlerën e plotë të kredisë në bilancin e gjendjes së tyre ose të mbështeten në faktorin kohë si dhe në përmirësimin e kushteve makroekonomike në mënyrë që ta kthejnë kredinë apo eventualisht ta ristrukturojnë atë. Pyetja që duhet të bëhet është se sa legjitime është kjo

KRIZA E CORONËS VETËM I KA SHTUAR PROBLEMET EKZISTUESE NË SEKTORIN FINANCIAR DHE BANKAR, EDHE SEGMENTET E TJERA TË EKONOMISË PO PËRBALLEN ME SFIDA TË REJA SHITESË

përballë një pasigurie të përgjithshme dhe befasive që mund të paraqiten brenda natës, ashtu siç është paraqitur kriza e Coronës.

Si shembull, Banka e Anglisë ka nisur të hulumtojë se për sa kohë mund të mbijetojnë bankat këtë sistem të mbylljes, meqë vlerësohet se kredidhënësit më të mëdhenjë tashmë kanë lënë mënjane afro 43.4 miliardë për t'i mbuluar kreditë e këqija. Rezultatet e hulumtimit duhet që po ashtu t'i japin Qeverisë së Anglisë informata kthesë që do t'i kontribuojnë hartimit të një strategjie për mënyrën e riaktivizimit të ekonomisë në mënyrë sa më shpejtë dhe sa më të lehtë.

Përveç faktit që kriza e Coronës vetëm i ka shtuar problemet ekzistue-

se në sektorin financiar dhe bankar, edhe segmentet e tjera të ekonomisë po përballen me sfida të reja shtesë. Kjo tregon se kompanitë me plane afariste emergjente dhe plane të ripërtëritjes pas fatkeqësive punojnë suksesshëm dhe efektshëm në kushtet e pandemisë së Corona virusit dhe merren më lehtë me efektet e krizës në kuptim të funksionimit dhe funksionalitetit të tyre. Duket se investimi në platforma të tilla viteve të fundit, siç është transferimi i sistemeve operative në platformat "cloud", i ka shërbyer shumë mirë riorganizimit të lehtë të punës nga një lokacion në një tjetër. Përkundër disa sfidave operative, shumica e tyre janë në gjendje t'iu përgjigjen me kohë kërkesave të klientëve të tyre dhe pronarëve, por edhe politikave rregullative me të cilat përballen. Ky organizim i punës është shumë i rëndësishëm, sidomos për ofruesit e shërbimeve. Meqë përdoruesit e shërbimeve të tyre dëshirojnë të jenë të sigurt për cilësinë e shërbimit që u ofrohet dhe për aftësinë e ofruesit të shërbimeve të tyre për të vepruar me sukses dhe për të qenë funksional edhe në emergjenca të tilla. Nuk është e pazakontë që përdoruesit e shërbimeve të bëjnë ndryshime dhe të kërkojnë ofrues më të mirë të të njëjtit shërbim - ndonjë që e trajton me sukses situatën, shfaq funksionim më të mirë dhe ka plane më të qëndrueshme të vazhdimësisë së biznesit - apo ta zgjedhin ndonjë alternativë ndaj praktikës së krijuar.

Sa i përket stabilitetit financiar të tyre, pothuajse kudo një gjë është e sigurt: njëra nga pasojat apo problemet kryesore që do të mbetet pas krizës së Coronës është vëllimi i shtuar dhe përkeqësimi i cilësisë së llogarive të arkëtueshme të papaguara. Duke i llogaritur efektet e krizës së Coronës, bankat dhe të gjitha subjektet afariste të tjera duhet ta shqyrtojnë seriozisht

se si do të përballen në periudhën e ardhshme me problemet që do t'i sjellë patjetër kjo krizë, veçanërisht në kuptim të shumës dhe vëllimit të shtuar të kredive të këqija në bilancet e gjendjes së bankave dhe vëllimit të shtuar të llogarive të arkëtueshme të papaguara me subjektet afariste. A ia vlen të llogaritet me kaq shumë risk në kushte kur tregu ofron zgjidhje?

Shitjet direkte janë njëra nga mënyrat për t'i trajtuar kreditë e këqija apo borxhet e këqija. Në shitje direkte, borxhet u shiten blerësve të interesuar, ndërsa shitësit duhet ta caktojnë një çmim të drejtë për të ndodhur shitja. Gjatë krizave, shitësit e zvogëlojnë ndjeshëm vlerën e pasurive, sidomos për asetet e këqija. Në anën tjetër, shitësit synojnë ta mbajnë çmimin e shitjes sa më afër vlerës së kredisë në librin e llogarive që të jetë e mundur. Sidoqoftë, ndryshimet në çmime mund të arsyetohen, pjesërisht për shkak të rregullores së re për mbrojtjen e të dhënave, që e bën të vështirë transferimin tek blerësit potencialë të disa parametrave të dhëna dhe të dhënave për mbajtësit e borxheve që në njëfarë mënyre i shtojnë vlerë borxhit dhe pjesërisht për shkak të këndvështrimit së kontabilitetit, sipas të cilit, për shkak të konceptit të vlerës kohore të parave, dhe duke i ndjekur parimet e kontabilitetit të SNRF-ve, rrjedha e parasë në të ardhmen zvogëlohet me normën origjinale efektive të interesit së asetit.

Rikthimi në "normalitetet" pas krizës së Coronës është sfidë vërtet serioze me të cilën po përballemi të gjithë. Tani po përballemi edhe me sfida të tjera. Në anën tjetër, na duhet patjetër një zgjidhje inovative dhe e shpejtë për të krijuar menaxhment produktiv në kushtet e reja dhe të ndryshuara dhe me sjelljen krejtësisht të ndryshuara të konsumatorëve, bashkëpunëtorëve dhe furnizuesve tanë.

SEKTORI BANKAR NË SHIFRA

2020



214

NUMRI I NJESIVE
BANKARE



513

NUMRI I ATM-VE



13,175

NUMRI I POS-AVE



347,199

NUMRI I LLOGARIVE
E-BANKING



1,354,940

NUMRI I KARTELAVE
BANKARE



3,381

NUMRI I TË PUNËSUARVE

Plani i detajuar mbi Menaxhimin e Riskut domosdoshmëri për kompanitë në ditët e sotme - Trajnim mbi Riskun e Likuiditetit



31.01.2020, **Prishtinë** - Që nga kriza financiare e vitit 2008, e përshkruar shpesh si krizë e likuiditetit, risku i likuiditetit është bërë një zonë kryesore e përqendrimit në menaxhimin e rreziqeve. Shumë nga ndryshimet në Bazeli III synojnë riskun e likuiditetit dhe mënyrën sesi bankat

mund të mbrohen kundër tij. Ky kurs është i organizuar me qëllim të ofrimit të institucioneve bankare dhe financiare një kuptim më të mirë të riskut të likuiditetit dhe mënyrën e menaxhimit të tij. Fushat e fokusit ishin të kuptuarit e formave të ndryshme të riskut të likuiditetit

dhe burimet e tyre, analizën e financimit dhe asetëve të likuiditetit të riskut, gjykimin në ndikimin e qeverisjes dhe strukturën organizative në riskun e likuiditetit, vlerësimin e mjedisit rregullator dhe të kuptuarit e ndryshimeve në Bazeli III në lidhje me riskun e likuiditetit.

Programi krahas trajnimit (3) ditësh solli përvojë të reja praktike ndërkompetare nga ligjëruesi me më shumë se 15 vjet përvojë të Menaxhimit të Riskut në Riskun e Likuiditetit, Z. Robert Bisticic.

Ky trajnim u organizua nga Shoqata e Bankave të Kosovës përmes Qendrës së saj të Trajnimit në bashkëpunim me House of Training / ATF dhe të mbështetur nga Qeveria e Luksemburgut.

Sfidat në zgjidhjen e kontesteve - Drejtësia komerciale në Kosovë



11.03.2020, **Prishtinë** - Përfaqësuesit të Shoqatës së Bankave të Kosovës priten në takim përfaqësues të projektit të USAID për Drejtësi Komerciale. Në Kosovë një nga sfidat dhe vështirësitë

vazhdon të mbetet zbatimi i kontratave për bizneset në Kosovë, andaj një nga prioritetet e këtij projekti të USAID është themelimi i Gjykatës për Drejtësi Komerciale.

Përfaqësuesit e të dy institucioneve diskutuan më në detaje për rëndësinë e këtij projekti, me fokus të veçantë në vlerësimin e nevojave për trajnime në të drejtën komerciale për gjyqtarët dhe stafin e gjykatës të cilët do të jenë pjesë e kësaj gjykate. Përfaqësuesit e projektit të USAID për Drejtësi Komerciale i njoftuan përfaqësuesit e SHBK-së mbi analizën e nevojave për trajnime si dhe për gjetjet kryesore të tyre. Përfaqësuesit e SHBK-së e vlerësuan lartë rëndësinë e këtij projekti dhe i ofruan mbështetje në këtë projekt.

Rregullat e kontabilitetit që bankat duhet të ndjekin për SNRF 9



12.03.2020, **Prishtinë** - SNRF 9 është Standard Ndërkombëtar i Raportimit Financiar i botuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit.

Ky standard adreson kontabilitetin e instrumenteve financiare. Tre temat kryesore që përmban SNRF 9 janë klasifikimi dhe matja e instrumenteve financiare, zhvlerësimi i aseteve financiare dhe kontabiliteti mbrojtës.

Trajnimi i mbajtur nga Shoqata e Bankave të Kosovës për industrinë bankare rreth SNRF 9 siguroi të kuptuarit e koncepteve dhe diskutimeve rreth SNRF 9 që merren rreth konceptit të portofolios së kontabilitetit të cilat

vendosin se cilat rregulla të kontabilitetit do të zbatohen dhe cilat shpalosje mund të jenë të nevojshme.

Trainimi SNRF 9 mbi rregullat e kontabilitetit që bankat duhet të ndjekin ka përfshirë edhe SNRF 5, 7, 13 dhe 16 të cilat janë rregulla të reja të kontabilitetit të publikuara.

Trajnimi u organizua nga Shoqata e Bankave të Kosovës në bashkëpunim me Shtëpinë e Trajnimit / ATTF e mbështetur nga Qeveria e Luksemburgut.

Delegacioni i Shoqatës së Bankave të Kosovës takohet me kryeministrin Albin Kurti pas shpalljes së gjendjes së emergjencës në tërë vendin



16.03.2020, **Prishtinë** - Delegacioni i Shoqatës së Bankave të Kosovës, pjesë e së cilës ishin drejtorët ekzekutiv të të gjitha bankave komerciale në Kosovë u takuan me kryeministrin e vendit Albin Kurti, ministrin për Financa dhe Transfere, Z. Besnik Bislimi, zëvendësministrin Z. Ilir Aliu dhe këshilltarin politik Z. Milot Cakaj. Kryeministri i vendit Albin Kurti me anë të një postimi ne faqen zyrtare të Facebook-ut theksoi se: “Takimi ishte i frytshëm dhe për këtë dua ta falënderoj secilin prej pjesëmarrësve. Unë i njoftova përfaqësuesit e bankave komerciale të Kosovës për situatën në të cilën ndodhemi pas shpalljes së gjendjes së emergjencës në tërë vendin dhe



po ashtu shtjelluam edhe implikimet që dalin për sistemin financiar të vendit. Përfaqësuesit e bankave komerciale treguan gatishmëri maksimale që të bëhen partnerë në gjithë përpjekjet për tejkalimin sa më të shpejtë dhe efikas të gjendjes ekzistuese, dhe gjithashtu më njoftuan për veprimet që ata kanë ndërmarrë për të akomoduar vendimet e qeverisë në këtë drejtim. Nga ky takim dolëm me këto porosi si për qytetarët ashtu edhe për komunitetin e biznesit:

1. Sistemi bankar i Kosovës ka likuiditet të mjaftueshëm dhe depozitat e qytetarëve janë të sigurta. Nuk ka pasur, nuk ka dhe nuk pritet të ketë asnjë kufizim në disponibilitetin e parasë së

gatshme në ekonomi. Andaj qytetarët dhe depozituesit mund të jenë të qetë në këtë drejtim.

2. Përfaqësuesit e bankave komerciale në Kosovë janë të vetëdijshëm që brenda sektorëve të caktuar të ekonomisë, një numër biznesesh që përdorin instrumente financiare të sistemit bankar mund të përballen me vështirësi të përkohshme për mbulim të kësteve mujore të kredive. Bankat e vendit do ta trajtojnë me kujdes secilin rast dhe do të dalin në ndihmë bizneseve në vështirësi përmes trajtimit miqësor të vonesave eventuale, duke mos llogaritur asnjë kamatë ndëshkuese për vonesa. Kjo pastaj do të ruajë edhe rejtingun kreditor të bizneseve.



Shoqata e Bankave të Kosovës diskutoi me Guvernatorin e BQK-së dhe Ministrin e Financave rreth planit të rimëkëmbjes ekonomike

28.05.2020, **Prishtinë** - Vlerësim të lartë për konstruktivitetin dhe punën e sektorit bankar gjatë periudhës pandemike. Me ftesë të Guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, Fehmi Mehmeti dhe Ministrit të Ekonomisë dhe Transfereve, Besnik Bislimi, në BQK u organizua një takim i përbashkët me të gjithë drejtuesit e bankave komerciale që operojnë në Kosovë.

Qëllimi i këtij takimi ishte diskutimi i zhvillimeve dhe masave të deritanishme për të ndihmuar përballjen e ekonomisë me pasojat e shkaktuara nga pandemia COVID-19, si dhe diskutimi i planit të rimëkëmbjes së ekonomisë për periudhën në vijim.

Me këtë rast, Guvernatori i BQK-së vlerësoi lart konstruktivitetin e treguar nga sektori bankar gjatë kësaj periudhe, duke iu përgjigjur pozitivisht nevojave të ekonomisë përmes lehtësimeve që

ju kanë bërë huamarrësve. Guvernatori Mehmeti shprehu bindjen se sektori bankar, i cili gëzon një shkallë të lartë të qëndrueshmërisë dhe potencial për të rritur edhe më tej kreditimin e ekonomisë, do të luajë një rol kyç gjatë fazës së rimëkëmbjes ekonomike duke shërbyer si partner i besueshëm i institucioneve, në përpjekjet për të ndihmuar rikuperimin dhe zhvillimin e mëtejshëm ekonomik të vendit.

Vlerësim të lartë për punën e sektorit bankar gjatë kësaj periudhe shprehu edhe Ministri Bislimi, i cili së bashku me Zëvendësministrin Ilir Aliu prezantuan para drejtuesve të bankave edhe planin për rimëkëmbje ekonomike, i cili po përgatitet nga një grup punues që përfshin përfaqësues të Qeverisë, BQK-së dhe bizneseve. Në thelb të këtij plani gjendet skema për garantimin e kredive, përmes së cilës synohet rritja

e financimit kreditor dhe përmirësimi i kushteve të financimit për bizneset dhe individët.

Nga ana tjetër, Albert Lumezi, Kryetar i Bordit të Shoqatës së Bankave të Kosovës, shprehi falënderimin për reagimin e shpejtë të BQK-së për sa i përket masave rregullative në raport me menaxhimin e situatës së krijuar gjatë pandemisë, si dhe mirëpriti iniciativën për krijimin e planit të rimëkëmbjes ekonomike, duke shfaqur gatishmërinë e sektorit bankar për të kontribuar në këtë proces.

Të gjitha palët u pajtuan për ta vazhduar bashkëpunimin e ngushtë në procesin e finalizimit të planit të rimëkëmbjes ekonomike dhe për domosdoshmërinë e fillimit sa më të shpejtë të implementimit të një plani të tillë në mënyrë që të minimizohen pasojat ekonomike të pandemisë dhe të ndihmohet rimëkëmbja dhe zhvillimi ekonomik i vendit.

Ministria e Financave ftoi në takim akterët nga sektori financiar për të diskutuar rreth programit të rimëkëmbjes ekonomike



17.06.2020, **Prishtinë** - Ministria e Financave ftoi në takim përfaqësuesit e Bankës Qendrore, Shoqatës së Bankave të Kosovës, Fondit të Kursimeve Pensionale dhe Administratës Tatimore për të bashkëbiseduar për thellimin e bashkëpunimit ndërinstucional me qëllim të rimëkëmbjes ekonomike. Ky takim i cili u mbajt nga ministria Bajrami për situatën ekonomike në vend dhe implikimet e shkaktuara

nga pandemia COVID-19 kishte fokus programin e rimëkëmbjes ekonomike, përkatësisht aspektet të cilat ndërlidhen me zbatimin sa më efikas të programit për rimëkëmbje ekonomike. Palët u pajtuan që të harmonizojnë veprimet sa i përket zbatimit dhe implementimit sa më efikas të programit për rimëkëmbje ekonomike përmes masave që nxisin aktivitetin ekonomik dhe ruajtjen e stabilitetit fiskal në Republikën e Kosovës.

Shoqata e Bankave të Kosovës u ftua në takim nga Ministria e Financave Znj. Hykmete Bajrami



07.07.2020, **Prishtinë** - Ministria Hykmete Bajrami ka pritur në takim drejtorin e Shoqatës së Bankave Z. Petrit Balijsë së bashku me zyrtarin e lartë për operacione Z. Kreshnik Kosumi me të cilët kanë diskutuar për situatën ekonomike në vend, me theks të veçantë në sektorin bankar.

Në takimin e mbajtur, Shoqata e Bankave të Kosovës theksoi rëndësinë që pakjoja shtetërore e ringritjes ekonomike të përmbajë masa të gjera dhe gjithëpërfshirëse për garanci të kredive dhe subvencionim të interesit për sektorët të cilët janë goditur financiarisht nga pandemia. Në takim u theksua gjithashtu rëndësia që të rritet mbulueshmëria e garancive kreditore deri në 100% duke përfshirë edhe fermerët e vegjël në kuadër të këtij mekanizmi financiar.

Në anën tjetër Ministria Bajrami e njoftoi Shoqatën e Bankave për angazhimin e Ministrisë së Financave dhe Qeve-

risë së Kosovës në adresimin e sfidave ekonomike dhe sociale të shkaktuara nga pandemia. Ajo shprehu gatishmërinë e institucionit që drejton për të rritur bashkëpunimin me Shoqatën e Bankave të Kosovës dhe institucionet financiare me qëllim të zhvillimit të sektorit privat.

Ndërsa drejtori i Shoqatës së Bankave Z. Petrit Balijsë, falënderoi Ministrin Bajrami për bashkëpunimin me sektorin bankar, veçanërisht Shoqatën e Bankave, dhe ofroi përkrahjen e Shoqatës për Qeverinë e Kosovës për implementimin e Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike.

Së shpejti mundësohet regjistrimi, modifikimi dhe fshirja e hipotekave kreditore përmes platformës elektronike

08.07.2020, **Prishtinë** - Shoqata e Bankave të Kosovës në bashkëpunim me Agjencinë Kadastrale të Kosovës (AKK) që nga viti 2018 kanë punuar në funksionalizimin e platformës elektronike e cila e mundëson regjistrimin, modifikimin dhe fshirjen (ç'regjistrimin) e hipotekave të cilat regjistrohen nga sektori bankar gjatë procesit të kreditimit.

Në kuadër të këtij bashkëpunimi janë zhvilluar shumë takime dhe punëtori të ndërsjellta, përfshirë një dinamikë të shtuar gjatë këtij muaji, me ç'rast si produkt ka rezultuar zhvillimi softuerik i platformës elektronike për komunikim ndërmjet bankave dhe sistemit të Agjencisë Kadastrale si dhe është bërë hartimi i dy udhëzimeve administrative prej AKK-së:

UDHËZIM ADMINISTRATIV MMPH - NR. 12/19 PËR NDARJEN DHE REGJISTRIMIN E PARCELËS;

UDHËZIM ADMINISTRATIV MMPH - NR. 11/19 PËR NDARJEN E NDËRTESES DHE TË PJESËS SË NDËRTESES;

Platforma elektronike për komunikim e cila mundëson regjistrimin, modifikimin dhe fshirjen e hipotekave tani më është aktive dhe mund të përdoret nga sektori bankar. Aktualisht sektori bankar është në fazën finale të punimeve për ndërlidhje të sistemeve të brendshme të tyre me sistemin elektronik të AKK-së dhe së shpejti bankat do të ndërlidhen me këtë platformë dhe fillojnë me regjistrimin elektronik.

Është e rëndësishme të vlerësohet se funksionalizimi i regjistrimit elektronik të AKK-së paraqet një arritje shumë të madhe, meqenëse regjistrimi, modifikimi dhe fshirja e hipotekave do të jetë shumë më efikase si dhe do të ketë ndikim të madh në rritjen e kreditimit përmes hipotekës për qytetarët e Koso-



vës. Krahas kësaj, platforma elektronike e komunikimit mundëson gjithashtu që të rritet transparenca dhe mënyra menaxhuese, duke bërë që edhe koha të shkurtohet gjatë procesit të kreditimit për klientët e bankave.

Shoqata e Bankave të Kosovës falënderon përfaqësuesit nga Agjencia Kadastrale e Kosovës për bashkëpunimin e ndërsjellë gjatë gjithë këtij procesi. Ky bashkëpunim pritet që të vazhdojë edhe më tutje për të siguruar një funksionim të efektshëm të këtij sistemi si dhe për avansimet e më tutje sipas nevojave dhe zhvillimeve në të ardhmen.

Diskutohet nënshkrimi elektronik si dhe çështjet e prapësimit me Këshillin Gjyqësor të Kosovës



07.10.2020, **Prishtinë** - Qëllimi i takimit ishte diskutimi rreth përdorimit të nënshkrimit elektronik nga bizneset në Kosovë si dhe zbatimi në praktikë i Ligjit për Shërbimet e Shoqërisë Informatike dhe përdorimi i nënshkrimit elektronik sipas këtij ligji nga sektori bankar si dhe çështja e prapësimit.

Drejtori Balijs, informoi Kryesuesin Çoçaj me problemet praktike dhe çështjet e ndryshme që ndërlihen me sistemin bankar në Kosovë.

Kryesuesi Çoçaj tha se, duke e respektuar ligjin dhe pavarësinë e gjyqësorit, Këshilli në bashkëpunim me gjykatat e Kosovës do të filloj ta trajtojë

këtë çështje me qëllim të zgjedhjes së më të mirë të mundshme për sistemin bankar. Çoçaj, shprehu gatishmërinë dhe përkrahjen e KGJK-së për të rritur bashkëpunimin me Shoqatën e Bankave të Kosovës, me qëllim të ofrimit të shërbimeve bankare sa më efikase për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Shoqata e Bankave të Kosovës merr pjesë në lansimin e dritares së Fondit Kosovar për Garanci Kreditorë sipas ligjit për rimëkëmbje ekonomike

14.12.2020, **Prishtinë** - Fondi Kosovar për Garanci kreditorë organizoi konferencë për lansimin e dritares për garantimin e kredive sipas ligjit për rimëkëmbje ekonomike. Në hapje të konferencës, z. Petrit Balijs, Kryeshef Ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës, theksoi se mirëpret rritjen e skemës garantuese përmes ligjit për rimëkëmbje ekonomike dhe se bankat komerciale të Kosovës do të vazhdojnë të mbështesin bizneset përmes rritjes së qasjes në financa. Në hapje të konferencës u mbajtën fjalime edhe nga Kryeministri i Kosovës z. Avdullah Hoti, Ministre e Financave znj. Hykmete Bajrami, Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës z. Fehmi Mehmeti, Kryetari i Bordit të Fondit Kosovar për Garanci Kreditorë z. Rinor Gjonbalaj si dhe Drejtori Ekzekutiv i Fondit Kosovar për Garanci Kreditorë z. Besnik Berisha. Në këtë ngjarje morën pjesë edhe udhëheqësit e bankave komer-

cialë si dhe të institucioneve financiare ndërkombëtare.

Me këtë rast Z. Balijsa potencoi që sektori bankar ka parandaluar një krizë kreditorë potenciale e cila jo rrallëherë shfaqet kur kemi të bëjmë me situata të jashtëzakonshme. Falë një angazhimi të madh bankat kanë arritur të aprovojnë kredi të reja në vlerë prej 1.2 miliard euro (sipas të dhënave të verifikuara në fund të muajit tetor), kështu duke tejkaluar edhe nivelin e kreditimit të vitit paraprak. Ky likuiditet i ofruar nga bankat i ka shërbyer bizneseve dhe ekonomive familjare si një urë financiare për tejkalimin e vështirësive të shkaktuara nga pandemia. Nga ky kreditim më së shumti kanë përfituar sektori i prodhimit dhe sektori i ndërtimit të cilat së bashku përfaqësojnë rreth 37% të portofolit kreditor të bizneseve.

Përkundër rrethanave të krijuara, normat e interesit për kredi kanë vazh-



duar të ulen duke shënuar 6.2% si normë mesatare në tetor 2020, krahasuar me 6.4% sa ishte në fund të vitit 2019.

Tutje Z. Balijsa theksoi që Shoqata e Bankave të Kosovës ka mbështetur Fondin Kosovar për garanci kreditorë që nga themelimi duke marrë pjesë në skemën garantuese në mënyrë shumë dinamike. Andaj ne mirëpresim aprovimin e ligjit për rimëkëmbje ekonomike i cili fuqizon fondin edhe më tutje dhe përmirëson kushtet specifike për garanci. Rritja e fondit dhe limitit të mbulueshmërisë së kredive do të mundësojë që të kreditohen biznese të segmenteve të cenuara nga pandemia në mënyrë që të vazhdojnë afarizmin e tyre për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, rritje të punësimit dhe një perspektivë më të mirë për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Banka CREDINS anëtarësohet në Shoqatën e Bankave të Kosovës

18.12.2020, **Prishtinë** - Shoqata e Bankave të Kosovës përmes një komunikate për media ka dhënë njoftimin që në tregun e Kosovës është shtuar edhe një bankë e re, CREDINS Bank e cila së fundi është licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës dhe është anëtarësuar në Shoqatën e Bankave të Kosovës.

Asambleja e Përgjithshme e Shoqatës së Bankave të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 nëntor 2020, ka aprovuar anëtarësimin me të drejta të plota për CREDINS Bank Kosova. Rrjedhimisht, Shoqata e Bankave të Kosovës tani përfaqëson 10 banka komerciale që operojnë në Kosovë.

Aksionari i vetëm i CREDINS Bank në Kosovë është CREDINS Bank në Shqipëri që operon që nga viti 2003 dhe është një nga bankat kryesore në Shqipëri. CREDINS Bank është banka e tretë më e madhe në Shqipëri duke mbajtur 14.4% të totalit të aktiveve të sistemit bankar të vendit, sipas të dhënave të Bankës së Shqipërisë.

Kryeshefi Ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës, Z. Petrit Balija theksoi se sektori bankar në Kosovë vazhdon të jetë një prej shtyllave kryesore të zhvillimit ekonomik në Kosovë dhe se ky sektor ka dëshmuar stabilitet dhe qëndrueshmëri ndër vite duke financuar bizneset dhe ekonomitë familjare. Me këtë rast Z. Balija tha “Jemi të nderuar që CREDINS Bank ka zgjedhur që të zgjerojë veprimtarinë e saj edhe në Kosovë për të qenë në shërbim të qytetarëve dhe ekonomisë së vendit. E mirëpresim anëtarësimin e CREDINS Bank në Shoqatën e Bankave të Kosovës dhe i dëshirojmë shumë sukses në tregun e Kosovës. CREDINS Bank do ta ketë mbështetjen tonë të pakursyer në rrugëtimin e saj të ri për rritjen e ofertës së shërbimeve financiare në sektorin bankar të Kosovës”.

Ndërsa Z. Selman Lamaj, Drejtor Menaxhues i CREDINS Bank Kosova, thekson se: “Vizioni i Bankës CREDINS në Kosovë është që të jetë pjesë e një rrjeti rajonal bankar që vepron në parimet komerciale të performancës dhe qëndrueshmërisë dhe të njihet si Banka me shërbim më të mirë në Kosovë. Misioni i Bankës CREDINS në Kosovë është të ofrojë shërbim cilësor ndaj klientit dhe të ndërtojë një biznes me njerëz të shkëlqyer, aktive dhe vlera që përmirësojnë standardin e jetesës. Banka CREDINS në Kosovë do të jetë një bankë e integruar, e fokusuar në inovacion. Qëllimi strategjik i Bankës është të jetë lider në eficiencë dhe të krijojë marrëdhënie dhe eksperiencë të shkëlqyera me klientët. Duke krijuar një strategji efektive të shitjeve, Banka do të ofrojë produkte dhe shërbime konkurruese dhe do të krijojë fushata atraktive marketingu”.

Për të përmbushur misionin e saj, Banka CREDINS në Kosovë ka vendosur disa objektiva strategjike si: ndërtimi i një kulture të shkëlqyer, motivuese e fituese, hartimi dhe zbatimi i procedurave fleksibël, të jetë një bankë model në shërbimin dhe përvojën e krijuar me klientin duke ndikuar në ngritjen e perceptimit të klientëve ndaj një niveli superior shërbimi dhe krijimin e besnikërisë ndaj bankës.

Synimi i bankës do jetë ngritja dhe zhvillimi i një banke e cila do të zhvillojë aktivitetin e vet bankar duke ofruar shërbime dhe produkte të ndryshme dedikuar individëve dhe bizneseve të Kosovës, të lançojë oferta dedikuar grupeve të ndryshme të klientëve për të qenë sa më pranë nevojave të tyre dhe të aplikojë një politikë atraktive çmimesh. CREDINS Bank do të adresojë një kulturë shitje efektive nëpërmjet stafëve në degë, por dhe nëpërmjet fushata-



ve të marketingut duke u fokusuar dhe tek pjesa e produkteve dhe marketingut digjital. Banka CREDINS në Kosovë do jetë një pjesëmarrëse aktive në zhvillimin ekonomik dhe social të Kosovës, duke mbështetur planet e investimeve të bizneseve vendase ose të huaja. Mbi të gjitha nëpërmjet shtimit dhe zgjerimit të rrjetit të degëve në Kosovë, do krijojë hapësira për punësim dhe zhvillim të talenteve të reja, duke ndërtuar një kulturë korporative që promovon karrierën dhe potencialin e tyre që të ndërtojë një ekip të fortë dhe me njerëz të talentuar.

Gjithashtu, rritja dhe praktikatat e mira bankare do të kenë mbështetjen nga Banka CREDINS në Shqipëri, e cila është solide në tregun bankar shqiptar duke operuar prej 17 vitesh dhe do të sigurohet që banka e re në Kosovë të ketë përshtatje shumë të mirë në treg. Banka CREDINS në Shqipëri ka 58 degë dhe renditet banka e parë në treg për nga madhësia e portofolit të kredisë dhe e dyta në total depozitash, çka tregon marrëdhënien e besueshme që mbi 300,000 klientët kanë ndërtuar ndër vite.

Shoqata e Bankave të Kosovës është themeluar në vitin 2002 si organizatë e cila shërben në funksion të bashkëpunimit ndërmjet sektorit bankar dhe autoriteteve shtetërore duke ofruar një platformë të vetme për avokim të përbashkët, diskutim të iniciativave të reja, identifikim dhe shqyrtimin e iniciativave ligjore dhe rregullative, koordinimin e aktivitetëve të përbashkëta për bankat si dhe ngritjen e kapaciteteve të stafit të bankave.

MBAHET KONVENTA VJETORE E SHOQATËS SË BANKAVE TË KOSOVËS PËR VITIN 2020

Shoqata e Bankave të Kosovës mbajti konventën vjetore bankare me datë 3 dhjetor me temë “Bankimi në kohën e COVID-19”. Për herë të parë Konventa Vjetore e Shoqatës së Bankave të Kosovës është mbajtur pa prezencë fizike, në një forum virtual për shkak të gjendjes së pandemisë dhe masave kufizuese për parandalimin e COVID-19.

Kjo konventë mbledhi përfaqësues të sektorit bankar në vend, nga bankat komerciale, institucionet shtetërore të vendit dhe institucioneve financiare ndërkombëtare me qëllim që të rrisë kuptimin e sfidave të shkaktuara si pasojë e situatës së pandemisë dhe të mundësojë një diskutim mbi masat e rëndësishme dhe shumë të nevojshme për një rimëkëmbje graduale.

Në fjalën e tij të mirëseardhjes, Kryeshefi Ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës Z. Petrit BALIJA, theksoi rëndësinë që ka kjo ngjarje për sektorin bankar dhe falenderoi bankat komerciale, Bankën Qendrore dhe institucionet financiare ndërkombëtare për mbështetjen e tyre për këtë organizim edhe në këto rrethana të vështira.

Hapja solemne e konventës është bërë nga Kryetari i Bordit të Drejtorëve të Shoqatës së Bankave të Kosovës njëherit Kryetar i Bordit Menaxhues të NLB Bankës, Z. Albert LUMEZI, i cili tha në mes tjerash se: “Për ne, si sektor bankar, ky vit po ashtu paraqet një vit ku ne jemi përkushtuar me të



gjitha mundësitë tona që të mbështesim klientët bankar dhe ekonominë e vendit. Që nga ditët e para të shpalljes së gjendjes së pandemisë COVID-19 në Kosovë, sektori bankar, përmes Shoqatës së Bankave në koordinim të ngushtë me Bankën Qendrore të Kosovës është mobilizuar për të ju përgjigjur gjendjes së krijuar.”

Në hapje të konventës ishte prezent edhe Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës Z. Fehmi MEHMETI i cili sqaroi për pjesëmarrësit të gjitha masat e ndërmarra deri më tani nga ana e Bankës Qendrore të Kosovës për të reduktuar pasojat e pandemisë në sektorin bankar dhe për të ruajtur sta-

bilitetin, njëkohësisht duke mundësuar lehtësime për bizneset dhe ekonominë familjare.

Pjesëmarrësit patën rastin të shohin edhe një prezantim nga Z. Robert WRIGHT - Nënkryetar i Bordit të Drejtorëve, Shoqata e Bankave të Kosovës / CEO, Raiffeisen Bank Kosova me temën ‘Bankimi në kohë të COVID-19’. Në këtë prezantim u parashtrua një perspektivë optimiste për të ardhmen e sektorit bankar por me një analizë mbi pasiguritë dhe paqartësitë të cilat mund të paraqiten në periudhat e ardhshme deri në tejkalimin e krizës shëndetësore dhe ekonomike të shkaktuar nga pandemia.

Ndërsa paneli diskutues rreth temës “Bankimi në Kohën e COVID-19” u udhëhoq nga Znj. Eriola BIBOLLI - Anëtare e Bordit të Drejtorëve, Shoqata e Bankave të Kosovës / CEO, ProCredit Bank Kosova, ku anëtarë të panelit ishin Z. Besnik BERISHA - Drejtor Menaxhues, Fondi Kosovar për Garanci Kreditore; Arton CELINA - Anëtar i Bordit të Drejtorëve, Shoqata e Bankave të Kosovës / CEO, Banka për Biznes; Gabriel DI BELLA - Udhëheqës i Misionit për Kosovën, Departamenti Evropian, FMN; Z. Sokol HAVOLLI - Zëvendës Guvernator, Banka Qendrore e Kosovës dhe Z. Massimiliano PAOLUCCI - Menaxher për Kosovën dhe Maqedoninë e Veriut, Banka Botërore.

PAGUANI ME KARTELË BANKARE



Shoqata e Bankave të Kosovës në bashkëpunim me Visa lansojnë fushatën informuese për rritjen e pagesave me kartela bankare në Kosovë dhe reduktimin e parasë KESH në ekonomi

Sektori bankar në Kosovë ka arritur që të ndërtoj një infrastrukturë mjaft të gjerë të pagesave e cila shtrihet në tërë Kosovën. Në këtë infrastrukturë bëjnë pjesë edhe pikat e shitjeve POS ku blerësit mund të bëjnë pagesat e tyre me kartela bankare. Duke pasur parasysh që përdorimi i kartelave bankare konsiderohet si një prej mundësive më të shpejta dhe më të sigurta për të kryer pagesat, edhe sektori bankar në Kosovë

i ka kushtuar një vëmendje të veçantë. Në këtë drejtim Shoqata e Bankave të Kosovës, me mbështetje nga bankat komerciale të Kosovës dhe Visa, ka lansuar një fushatë informuese për të sqaruar se cilat janë përfitimet e qytetarëve nëse kryejnë pagesat e tyre me kartelë bankare.


Kjo fushatë ka për qëllim të rrisë besimin në përdorimin e kartelave bankare dhe të ndikoj pozitivisht te rritja e page-

**FUSHATA KA PËR QËLLIM
TË RRIË BESIMIN
NË PËRDORIMIN E
KARTELAVE BANKARE
DHE REDUKTIMIN
E PARASË KESH NË
EKONOMI.**





A ka kosto për mua nëse paguaj me kartelë?



save me kartela bankare në Kosovë dhe reduktimin e parasë KESH në ekonomi. Reduktimi i përdorimit të parasë së gatshme dhe rritja e pagesave elektronike do të kontribuonte edhe në luftimin e ekonomisë informale e cila shpesh përcjellët me transaksione me KESH

por edhe do të rriste konkurrencën në fushën e pagesave e që sjell përfitime të shumta për konsumatorët poashtu edhe për bizneset si dhe ekonominë në tërësi.

Përfitimet janë të shumta duke përfshirë ato si në vijim:



Kartela bankare ju ofron siguri dhe lehtësi në pagesat tuaja duke mundësuar edhe transaksionet pa kontakt për shumta të vogla dhe të përditshme. Në këtë kohë pandemie, kjo mundësi për të paguar pa kontakt ndikon edhe në parandalimin e shpërndarjes së virusit Covid-19.

Pagesa me kartelë bankare kursen kohën pasi që nuk keni nevojë që çdo herë të bëni tërheqje të parasë KESH në bankomat dhe të mbani KESH me vete, gjithashtu me kartelë bankare mund të bëni blerje dhe pagesa online kështu duke kursyer kohën tuaj

Pagesat me kartelë bankare regjistrohen në raportin tuaj bankar duke mundësuar menaxhimin më të mirë të shpenzimeve dhe financave personale.

Pagesat me kartelë bankare reduktojnë përdorimin e KESH-it e që ndihmon në luftimin e ekonomisë jo-formale dhe parasë së falsifikuar.

Pagesat me kartelë bankare mund të bëhen në të gjitha pajisjet POS të bankave të Kosovës, pa asnjë kosto shtesë dhe pa dallim në shumën që e paguani, kosto e transaksionit për kartelë mbajtësit është ZERO.

Fushata do të zhvillohet gjatë muajve shtator -nëntor 2020 dhe pritet të ketë ndikim pozitiv për klientët bankar, për avansimin e tregut të pagesave si dhe për ekonominë e Kosovës në tërësi.

MENAXHONI FINANCAT TUAJA MË MIRË, RUANI SHËNDETIN DHE KURSENI KOHËN DUKE PAGUAR ME KARTELË BANKARE!

Banka Raiffeisen nënshkruan Memorandum bashkëpunimi me zyren e UNICEF-it në Kosovë

Ëndrra e djaloshit 14 vjeçar nga Prizreni, të bëhet programer, u bë realitet. Banka Raiffeisen Kosova ia dhuroi tabletin me të cilin Efe do të hyjë në botën e programimit, të eksplorojë e mësojë dhe realizojë ëndrrën e tij të jetës. Efe, është një nga 151 fëmijët të cilët Raiffeisen Bank Kosova i ka pajisur me tablete dhe paisje shkollore në regjionin e Prizrenit.

Raiffeisen Bank Kosova nënshkroi një Memorandum Mirëkuptimi për ta formalizuar angazhimin dhe partneritetin me Zyrën e UNICEF-it në Kosovë, me qëllim të rritjes

së bashkëpunimit për promovimin e çështjeve me rëndësi sociale siç janë të drejtat themelore të njeriut, kujdesi ndaj fëmijëve, si dhe rritja e bashkëpunimit për të krijuar një mjedis më të mirë e më të qëndrueshëm për çështjet që janë krijuar nga pandemia COVID-19.

Si rezultat i këtij partneriteti strategjik, 151 tablete dhe 275 çanta shkollore u janë dhuruar fëmijëve në regjionin e Prizrenit – komuna e dytë më e madhe – me përkrahjen e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe au-



toriteteve lokale dhe donacionit nga fondacioni H. Stepic CEE Charity nga Viena.

Banka Ekonomike dhuron donacion për Komitetin e grave të verbëra të Kosovës



Në kuadër të përgjegjësisë sociale, Banka Ekonomike ka vazhduar të mbështesë kategori të ndryshme të shoqërisë sonë,

mision ky të cilin e kemi fokus të veçantë. Në këtë drejtim, sot Banka Ekonomike ka dhuruar një donacion me paisje

kompjuterike të nevojshme për punën e komitetit të grave të verbëra të Kosovës. Ky donacion, do të lehtësojë dhe do të ndihmojë funksionimin e komitetit, duke përmirësuar edhe më shumë infrastrukturën e punës, si dhe këto paisje do të shfrytëzohen poashtu për trajnime për gratë e komitetit.

Banka Ekonomike do të vazhdojë edhe me forma të tjera të mbështetjes për kategori të caktuara të cilat kanë nevojë për mbështetje dhe të cilat ndikojnë direkt në mirëqenien e përgjithshme qytetare.



Banka Ekonomike dhuron donacion tablete për nxënësit e Komunës së Prishtinës

Duke parë nevojën për mbështetje pas rrethanave të krijuara si pasojë e Covid-19, Banka Ekonomike në kuadër të përgjegjësisë sociale ka vendosur t'i bashkohet iniciativës së Komunës së Prishtinës për t'i ndihmuar nxënësit në nevojë të cilët nuk mund të përfshihen në mësimin online me bashkëmoshatarët e tyre. Me këtë rast Banka Ekonomike ka dhuruar një numër të

tableteve donacion për Komunën e Prishtinës, të cilët do t'u shpërndahen nxënësve të Prishtinës.

Banka Ekonomike do të vazhdojë edhe me forma të tjera të mbështetjes për kategori të caktuara, duke u bërë të gjithë bashkë për t'a kaluar sa më lehtë këtë periudhë të vështirë për të gjithë ne.

Banka Ekonomike dhuron donacion një Tunel Dezinfektues për SHSKUK



Në ditët e fundit kemi pasur një ulje të theksuar të rasteve të reja me COVID-19, si dhe numër rekord të qytetarëve të shëruar, dëshmi kjo që tregon se falë punës së jashtëzakonshme të profesionistëve tanë

shëndetësor, institucioneve dhe qytetarëve tanë, tashmë jemi në rrugë të mirë të mposhtim virusin COVID-19.

Banka Ekonomike duke parë rrezikun e vazhdueshëm me të cilin përballen çdo

ditë profesionistët tanë shëndetësorë dhe qytetarët, me qëllim që të kontribuojnë në vazhdimësi në luftën kundër COVID-19, sot ka dhuruar donacion për Shërbimin Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës - SHSKUK një "Tunel Dezinfektues", i cili do të jetë i vendosur në hyrje të Klinikës Emergjente, për t'u shfrytëzuar nga punonjësit shëndetësor dhe qytetarët.

Rezultatet e fundit, nuk duhet të na relaksojnë dhe as të na largojnë vëmendjen tonë nga respektimi i plotë i të gjitha rekomandimeve nga institucionet përkatëse për kujdes të shtuar, deri në largim të plotë të virusit nga mesi ynë! Në kuadër të përgjegjësisë sociale, në ditët në vijim Banka Ekonomike do të vazhdojë edhe me forma tjera të mbështetjes për kategori të caktuara, duke u bërë të gjithë bashkë për ta kaluar sa më lehtë këtë periudhë aspak të mirë për të gjithë ne.

TEB vazhdon përkrahjen e "Dardanëve"



Banka TEB vazhdon të jetë përkrahëse e fuqishme e përfaqësueses së Kosovës të futbollit edhe për edicionin e ardhshëm kualifikues.

Një bashkëpunim i filluar katër vite më parë kur filloi edhe rrugëtimi i futbollit të Kosovës në arenën ndërkombëtare ka vazhduar me një bashkëpunim të ri ndërmjet bankës TEB Sh.A. dhe Federatës së futbollit të Kosovës (FFK).

Marrëveshja e sponsorizimit është zyrtarizuar me një konferencë rasti sot në Prishtinë, sipas të cilës Banka TEB vazhdon përkrahjen e përfaqësueses së Kosovës në futboll edhe për dy vite të ardhshme. Drejtori menaxhues i TEB Sh.A., Z. Orcun Ozdemir u shpreh i kënaqur me marrëveshjen e zgjatur. "Kemi filluar përkrahjen e futbollit të Kosovës që në ditët e para të përfaqësimit ndërkombëtar dhe këtë po e vazhdojmë edhe

sot. Falënderojmë Federatën e futbollit të Kosovës dhe presidentin, Z. Ademi i cili ka aprovuar bashkëpunimin tonë që shprejsojmë të vazhdojë edhe më tutje", tha ai. Presidenti i FFK-së, Z. Agim Ademi shprehu falënderim për Bankën TEB për mbështetjen e dhënë. "E vlerësojmë lartë bashkëpunimin me Bankën TEB që nga ditët e para të ndërkombëtarizimit dhe shprejsojmë se këtë besim përveç obligimeve kontraktuale do ta shpërblejmë edhe me paraqitje të mirë", tha ai.

Kapiteni i Kosovës, Z. Amir Rrahmani u shpreh falënderues që bashkëpunimi me një sponsor si TEB do të vazhdojë edhe për një periudhë kualifikuese, e cila fillon me ndeshjen e 3 shtatorit në Parma të Italisë ndaj Moldavisë nikoqire dhe tri ditë më vonë në "Fadil Vokrri" me Greqinë mysafire.



TEB dorëzoi donacionin e dytë në SHSKUK

Banka TEB ka dorëzuar donacionin e dytë për Shërbimin Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (SHSKUK) në Prishtinë brenda një periudhe tre mujore.

Pas donacionit të parë që ishte kërkesë emergjente për mbrojtjen e mjekëve në Klinikën e Infektivës gjatë trajtimit të pacientëve me virusin COVID-19, sot është ndarë donacioni i dytë me 10 pompa infuzive (perfuzomat) elektronike për trajtime me oksigjen dhe shiringa të specializuara për këto pajisje.

Drejtori menaxhues i TEB Sh.A., Z. Orcun Ozdemir tha se përkrahja e Bankës nuk do të mungojë edhe në të ardhmen. "Në këtë kohë ne si Bankë marrim përgjegjësinë tonë sociale koorperative dhe mendojmë se të gjithë duhet të përkrahim iniciativat në përkrahje të mjekësisë në këtë kohë të jashtëzakonshme. Puna të cilën po e bëjnë mjekët është e jashtëzakonshme dhe të gjithë duhet të qëndrojmë pranë tyre. Përkrahja jonë nuk do të mungojë edhe në të ardhmen", tha ai.

Ushtruesi i detyrës së drejtorit të SHSKUK-së, Z. Valbon Krasniqi falenderojë Bankën TEB për ndihmën e ofruar. "Ju falenderojmë për ndihmën e dhënë dhe ju sigurojmë se këto pajisje do të janë në shërbim të pacientëve, ndërsa është detyrë e jonë të ju sigurojmë se do të përdoren dhe mirëmbahen në mënyrën më të mirë", tha ai.

BPB ka dezinfektuar 50 lokale të bizneseve kosovare për të i ndihmuar ata në luftën kundër pandemisë COVID-19

"Të gjithë jemi të vetëdijshëm për vështirësitë që po kalon biznesi kosovar si pasojë e pandemisë Covid19. Duke marrë parasysh që ne synojmë të jemi banka numër 1 në Kosovë në përkrahjen e bizneseve të vogla, dhe jo vetëm si ofrues i shërbimeve financiare, kësaj radhe kemi zgjedh një numër të bizneseve të cilëve ju kemi sponsorizuar dezinfektimin e lokaleve ku ata operojnë për të ju ndihmuar në luftën kundër Covid19! - tha Fisnik Bokshi, menaxher i marketingut në BPB.

Ky është projekti i dytë i këtij lloji që ndërmer BPB, pasi që kohë më parë



kanë shpërndarë dezinfektues dhe pano vetëdijësuese në 500 biznese në Kosovë. Për më shumë, BPB është zotuar se do të vazhdojë të ndihmojë në luftën kundër pandemisë dhe se ka projekte të reja në këtë drejtim për të cilat do të dëgjojmë së shpejti.

Banka për Biznes me donacion për Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare



BPB ka njoftuar se së fundmi ka shpërndarë 65 Pulsoksimetër tek Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Kosovë. Këto aparate do të shpërndahen nëpër qendrat e mjekësisë familjare në të gjithë Kosovën. Donacioni për QKMF është bërë për të ndihmuar mjekët në luftën e tyre kundër pandemisë dhe në shenjë mirënjohjeje për kontributin e pakursyer të personelit mjekësor për gjatë kësaj kohe të vështirë për të gjithë ne. Këto pajisje mjekësore shërbejnë për matjen e nivelit të oksigjenit dhe matjen e pulsit aktual të zemrës, që janë indikator të rëndësishëm në identifikimin e hershëm të simptomave tek pacientët e prekur nga ky virus.

"Jemi munduar që përmes këtij donacioni, sado pak t'ua lehtësojmë punën personelit mjekësor të angazhuar drejtpërdrejt me të prekurit nga kjo pandemi. Besojmë që këto aparate të ndikojnë në identifikimin e hershëm të virusit të bashkatdhetarët tanë, dhe si rezultat ata ta kalojnë më lehtë këtë sëmundje. Ky është projekti ynë i tretë për të ndihmuar në parandalimin dhe luftimin e pandemisë "COVID-19", pasi që kohë më parë BPB ka realizuar edhe dy projekte të ngjashme duke shpërndarë 500 dezinfektues tek bizneset e vogla në të gjithë territorin e Kosovës dhe duke dezinfektuar ambientet e 50 bizneseve kosovare" - tha Anita Kosumi-Ajeti, Udhëheqëse e departamentit të Burimeve Njerëzore në BPB. Përndryshe, BPB njihet si banka më e suksesshme vendore, e shpallur dy vite më radhë si banka më e mirë në vend nga prestigjiozja "The Banker", publikim i Financial Times .

Banka për Biznes shpërndan 500 dezinfektues te bizneset e vogla në gjithë territorin e Kosovës



BPB ka njoftuar se së fundmi ka shpërndarë 500 dezinfektues nëpër bizneset e vogla në të gjithë territorin e Kosovës.

Së bashku me dezinfektues BPB ka dhënë edhe nga një etiketë ku ju rikujton klientëve që të mbajnë maskën, të mbajnë distancën

dhe të dezinfektojnë duart para se të hyjnë në lokalet e bizneseve.

‘Ne e kemi rrjetin e degëve të shtrirë në të gjithë territorin e Kosovës dhe përmes këshilltarëve të bizneseve kemi qenë vazhdimisht në kontakt me klientët tonë, ku përveç

shërbimeve financiare kemi ofruar edhe këshilla financiare. Qëllimi ynë është të ofrojmë një përkrahje gjithëpërfshirëse për bizneset e vogla dhe mikro. Në projektin e radhës ne kemi shpërndarë 500 dezinfektues dhe shenja informuese te 500 biznese kosovare, me qëllim të parandalimit të përhapjes së pandemisë dhe ngritjes së vetëdijesimit të qytetarëve’ – tha Bujar Statovci, Udhëheqës i departamentit të biznesit në BPB. Ky është projekti i dytë i bankës për të ndihmuar në parandalimin e virusit Covid19, pasi që kohë më parë BPB ka realizuar një projekt të ngjashëm edhe me SOS Fshatrat e Kosovës.

Përndryshe, BPB njihet si banka më e suksesshme vendore, e shpallur dy vite më radhë si banka më e mire në vend nga prestigjiozja The Banker, publikim i Financial Times.

BKT: Gjaku yt shpëton jetë

Për nder të Ditës së Dhurimit të Gjakut, më 14.06.2020, BKT Kosova në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut, vijoi dhurimin e gjakut, që tashmë është traditë disa vjeçare e bankës. BKT vazhdon të jetë përkrahëse e veprimeve që në qendër kanë individin dhe mbështetjen e tij në komunitet. Niveli i lartë i pjesëmarrjes së punonjësve tanë në aktivitetin e dhurimit të gjakut dhe vullneti i tyre



për të kontribuar në shëndetin e të tjerëve vërteton vazhdimisht se përqëndrimi ynë duhet të jetë krijimi i një ndikimi pozitiv në shoqëri.

“Gjaku yt shpëton jetë” është pjesë e programit tonë për përgjegjësi sociale, i bazuar në parimin “Kontribuo për shoqërinë”, që i adresohet mbështetjes së Bankës Kombëtare Tregtare ndaj veprimtarive bamirëse.

BKT: Mbështetja e personave me autizëm, veprim human i çmuar

Mbështetja dhe përkujdesja ndaj personave me nevojë të veçanta në Kosovë tashmë ka marrë kahje të dëshirueshme, ndërsa ka shumë organizata të cilat ndihmojnë dhe përkujdesen për personat që kanë nevojë për një përkujdesje të veçantë.

BKT Kosova ka nënshkruar Marrëveshje bashkëpunimi me Shoqatën ‘Autizmi’ me seli në Prishtinë, për mbështetje financiare për trajtimin e fëmijëve me autizëm në



periudhë 12 mujore. Këtë mbështetje e ka mirëpritur edhe shoqata, ‘Autizmi’ e cila falënderon Bankën Kombëtare Tregtare për mbështetjen, ndërsa shpresojnë se shembullin e kësaj banke ta marrin edhe të tjerët, njerëzit e vullnetit të mirë e kushdo tjetër për të mbështetur fëmijët me autizëm të cilët kanë nevojë të ndihen komod dhe pjesë e shoqërisë.

NLB Banka mbështet bizneset mikro dhe të vogla përmes projektit #KornizaeMbështetjes

Kosova është një vend me shumë biznese. Shumica e qytetarëve janë të punësuar në biznese të vogla dhe mikro që janë shtyllë e rëndësishme e ekonomisë dhe janë prekur më së shumti nga kriza globale e shkaktuar nga pandemia COVID-19.

Kjo është arsyeja pse NLB Banka ka realizuar projektin #KornizaeMbështetjes për t'i mbështetur bizneset mikro dhe të vogla në rikthimin pas pandemisë dhe në zhvillimin e biznesit duke iu dhuruar hapësirë reklamuese në kanale televizive, portale informative, rrjete sociale, billboard dhe citylight në të gjithë Kosovën.



Nga ky projekt kanë përfituar 20 biznese vendore nga e gjithë Kosova që kanë aktivitete prodhimin e produkteve vendore, tregtinë, shërbimet, agrikulturën si dhe sjellin projekte inovative për mbrojtje të mjedisit dhe mirëqenies sociale. #KornizaeMbështetjes është mirëpritur nga bizneset si ndihmë në këto kohë të vështira. Marketingu i realizuar për bizneset përfituese, i financuar nga Banka, ka sjellë efekt pozitiv edhe në rikthimin në treg dhe zhvillimin e mëtejshëm.

Banka ProCredit dhuron donacion me materiale mbrojtëse ndaj COVID-19


ProCredit Bank ka dhuruar donacion me materiale mbrojtëse për COVID-19 për punëtorët shëndetësor të klinikave të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës të cilët punojnë me pacientë. Në donacion janë përfshirë veshje, dezinfektues, maska, dorëza, termometra dhe material tjera të nevojshme të cilat do të shërbejnë si ndihmë për qytetarët e Kosovës në luftën kundër pandemisë.

Drejtori i përgjithshëm i Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, Dr. Basri Sejdiu, falënderoi bankën për donacionin duke theksuar se ky donacion vjen në kohën më të duhur!

Gjatë dorëzimit të donacionit, Banka ProCredit theksoi se edhe ky donacion me materiale të nevojshme për mbrojtje


ndaj COVID-19 vjen si rezultat i politikave tona të përgjegjësishë shoqërore që aplikojmë tash e 20 vite.





**QË 16 VJET I JAPIM
NGJYRË DOKUFEST-it.**

**ProCredit Bank
Sponsor gjeneral**



16 vjet në mbështetje të Festivalit Ndërkombëtar të Filmit Dokumentar dhe të Shkurtër – DokuFest

Banka ProCredit ka pasur një rol të rëndësishëm në mbështetjen e kulturës në vendin tonë për dy dekada duke qenë më shumë një partner se sa një mbështetës komercial i ngjarjeve kulturore. Vet mbështetja e DokuFest si Sponsor Gjeneral për 16 vite rradhazi tregon përkushtimin e ProCredit për përkrahjen ndaj zhvillimit të festivalit më të madh në Kosovë.

Ky vit shënon edicionin e 19-të të festivalit si dhe herën e parë që DokuFest

vjen në një format online. I themeluar në vitin 2003, me qëllim të revitalizimit të kulturës së kinemasë në Prizren, DokuFest u rrit dhe u zgjerua në një rëndësi të rëndësishme të filmit dhe muzikës në Europën Juglindore dhe prej vitit 2020 edhe festivali kualifikues në BAFTA.

Duke pasur parasysh ndikimin e pandemisë në të gjitha sferat jetësore, mbështetja e skenës së pavarur kulturore sidomos këtë vit, është tejet e rëndësishme

sidomos duke pasur parasysh edhe efektin e saj mbi shëndetin social dhe mendor të njerzimit, duke mos anashkaluar edhe ndihmën ekonomike që ju duhet për të mbijetuar këtë krizë globale.

Ne besojmë fuqishëm që një bashkëpunim i tillë i institucioneve si në këtë rast, është i domosdoshëm dhe me një rëndësi të madhe duke pasur parasysh misionin e përbashkët: Fuqizimin e skenës kulturore dhe rritjen ekonomike të vendit tonë.

PUBLIKIMET E SHOQATËS SË BANKAVE TË KOSOVËS

“The Kosovo Banker” është botim i Shoqatës së Bankave të Kosovës. Revista botohet dy herë në vit dhe ka për qëllim të informojë publikun lidhur me industrinë bankare në Republikën e Kosovës. Për më tepër informata, drejtohuni tek web faqja e Shoqatës së Bankave të Kosovës.





QENDRA E TRAJNIMEVE NË SHOQATËN E BANKAVE TË KOSOVËS

Organizon trajnime për sektorin financiar të Kosovës:

- > Rregullorja e menaxhimit të riskut për bankat
- > SNRF 9 - Rregullat e reja të kontabilitetit për Instrumentet Financiare
- > SWIFT në tregun e pagesave
- > Analiza e deklaratave të një banke
- > Sjellja etike në bankë
- > Rreziku i kredisë për bankat
- > Rreziku operacional për bankat
- > Rreziku i likuiditetit për bankat
- > Etika në bankë
- > Auditimi dhe kontrolli i brendshëm
- > Bankimi dixhital
- > Retail banking, kanalet e reja të shpërndarjes dhe e-bankingu
- > FINTECH
- > Teknologjia Blockchain për bankat
- > Menaxhimi i pasurive dhe pasiveve
- > Mbrojtja e të dhënave personale
- > Standardet bankare BASEL
- > E ardhmja dixhitale e bankave retail



SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS
KOSOVO BANKING ASSOCIATION

f #KosovoBankingAssociation

in #KosovoBankingAssociation

Shoqata e Bankave të Kosovës
është anëtare e Rrjetit Evropian
për Trajnime Bankare (EBTN).



PARTNERËT:

LUXEMBOURG
AID & DEVELOPMENT



Qendra për trajnime bankare në kuadër të programit të saj të trajnimeve ofron edhe certifikime të njohura ndërkombëtare, uebinare dhe trajnime përmes kanaleve elektronike në fushën e industrisë bankare.